



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Teknikë Imazherie”

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gazment KODUZI


Dr. Ermal TAKO

A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized representation of the name "Gazment Koduzi".

Gusht / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË “TEKNIKË IMAZHERIE”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencor në “Teknikë Imazherie”
4	Urdhri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 51, datë 06.02.2017
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 13 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 13 Studentë; 2021-2022 24 Studentë; 2022-2023 30 Studentë; 2023-2024 34 Studentë;
19	Komente / të tjera:	



PERMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT), është themeluar në vitin 2013 me VKM Nr. 48, datë 23.01.2013, nga Universiteti i Tiranës disa prej njësive kryesore të tij të fushës së shkencave mjekësore. Në vitin 2016, UMT u riorganizua dhe tashmë përbëhet nga tri fakultete:


1. Fakulteti i Mjekësisë;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Fakulteti i Mjekësisë Dentare;

Aktualisht në strukturën akademike të UMT përfshihen, 3 fakultete, 22 departamente, 72 shërbime shëndetësore (me funksion diagnostikues-trajtues dhe mësimor, kërkimor shkencor), 1 qendër për zhvillimin profesional (3. Organigrama UMT) si dhe 8 Struktura Shëndetësore Universitare publike, nga të cilat 5 Struktura shëndetësore spitalore universitare publike. Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 03, datë 27.01.2023 maksimalisht me 6 vite me afat vlefshmërie deri në 26/01/2029.

Ndërsa Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) është aktualisht fakulteti më i madh me 2600 studentë aktive. FSHMT përbëhet nga 3 njësi bazë në të cilat janë të punësuar rreth 65 personel akademik, 28 personel ndihmës akademik, 16 personel administrativ dhe 289 personel akademik ke kohë të pjesshme. (Evidenca nr 7. Organigrama Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike).

Programi i studimit është hapur për herë të parë në vitin 2009 me VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009 në formën e programeve DND në Fakultetin e Infermierisë. Me Urdhër të MAS Nr.51, datë 06.02.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhërin nr. 297, datë 20.07.2012 për regjistrimin e formës së diplomës të programeve të studimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, është regjistruar diploma e programit të studimit me emërtimin e tij “MSc. Teknikë Imazherie”. Fakulteti është përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e programit duke koontribuar tre departamentet dhe strukturat e tjera duke dhënë kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit. (Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT, Evidenca nr 6. Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ).

Në këtë fushë studimi fakulteti ofron dhe programet Bachelor, Master Profesional e Master i Shkencave në Teknik Imazherie. Programi i studimit akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknikë Imazherie” ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjeksësore Teknike (FSHMT), “Universiteti i Mjekësisë, Tiranë” (UMT).

Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kriterëve të ciklit të dytë pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve respektive. (ascal.al)

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:


- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht;

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit (ascal.al) të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 6 muaj (Evidenca nr 103.Agjenda e fazës së vlerësimit për programin e studimit).

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjyqimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof.As. Gazmend Koduzi dhe Dr. Ermal Tako. Koordinatorë Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Majlinda Demirneli.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UMT e zhvilluar në datat 28 dhe 29 Shkurt 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.



Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e FSHMT. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm studentëve dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu GVJ vlerëson edhe mbështetjen e ASCAL në këtë proces të parë të realizuar për këtë program studimi. Nga ana tjetër shprehim bindjen se ky akreditim i parë, gjetjet dhe konstatimet në këtë raport, do ti vlejné institucionit të përmirësoje më tej programin e studimit.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.07.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 86/22 Prot, datë 01.07.2024. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, njofton më datë 18.07.2024, nëpërmjet sistemit me shkresën me nr. 315/12, prot, datë 17.07.2024, ” *Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. 86 / 22 Prot, datë 01.07.2024*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Teknikë Imazherie"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, është një institucion publik i arsimit të lartë, licencuar në vitin 2013 dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Vendimi nr.3, date 27.01.2023, me kohëzgjatje 6 vite akademike. Institucioni ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikëbërëse në fushën e shëndetësisë. Ky program studimi ofrohet në nivel Fakulteti me kontribut të çdo njësie, strukture të fakultetit dhe universitetit në tërësi. Programi i studimit i ofruar nga FSHMT, është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit UMT. Evidenca nr 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; Evidenca nr 2. Rregullore UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 170. Plani Strategjik I Zhvillimit të UMT –së v.2021-2024;
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në Teknikë Imazherie është në përputhje me profilin që ka UMT. Spektrin e vevojave që kanë qendrat spitalore, shëndetësore publike e private në vend duke përfshirë në to personel të specializuar në fushën e teknikut të imazherisë. Programi i studimit i ofruar nga FSHMT është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t'u bërë ekspertë të denjë të fushës së imazherisë dhe radioterapisë. Bazuar në informacionin e dhënë,



	Programi synon edukim të studentëve, duke ruajtur dhe konsoliduar vlerat akademike e kulturore kombëtare në të njëjtën linjë me interesat kombëtare. Evidenca nr 1. Statuti UMT; Takimi me drejtuesit e FSHMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit;
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	GVJ evidenton se programi i studimit është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të institucionit. Përmbajtja e tij, është hartuar, përditësuar dhe përshtatur nevojave që ka vendi por njëkohësisht ka reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e imazherisë. Misioni dhe qëllimi i programit të studimit është përgatitja e specialistëve të aftë të fushës së imazherisë dhe diagnostikës. Pajisja e këtyre specialistëve me teknikat, instrumentet dhe metodat më bashkëkohore (sasiore dhe cilësore), përmes të cilave ofrohen zgjidhje për probleme të ndryshme me të cilat ata do të përballen gjatë ushtrimit të profesioni të tyre. Pajisja e radiologëve me njohuritë më të avancuara teorike e praktike, duke bërë të mundur në këtë mënyrë, absorbimin e tyre nga tregu i punës brenda dhe jashtë vendit sikundër citohet edhe në dosjen e prograit të studimit. Referuar dokumentacionit mbështetës, rezulton se programi ka objektiva të qarta që synojnë jo vetëm edukimin e specialistëve në fushat mjekësore për të shërbyer sa më mirë rrjetit shëndetësor vendas dhe jashtë tij, por edhe edukimin e tyre në vazhdim për t'u përshtatur me zhvillimet e mjekësisë bashkëkohore. Evidenca nr 86. Programi i studimit Objektivat e programit; Evidenca nr 97. Statistika; Evidenca nr 108. Zyra e karrierës;
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Programi i studimit është hartuar bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, Strategjinë e zhvillimit institucional të UMT, Strategjinë kombëtare të punësimit dhe arsim, Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së FSHMT.

vendas dhe atë ndërkombëtar.	Evidenca nr 1. Stauti i UMT; Evidenca nr 170. Plani Strategjik I Zhvillimit të UMT-së v.2021-2024;			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Satutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UMT, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Në të njëjtën linjë, edhe programi MSc. Teknikë imazherie zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit të mjekësisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit MSc. në Teknikë Imazherie është hartuar në përputhje me nevojat që ka vendi dhe tregu i punës duke përgatitur specialistë radiologjie, të cilët për shkak se janë të kërkuar nga tregu i punës, largohen jashtë vendit e në këtë mënyrë programi ndihmon në zbutjen e kërkesës që ka sistemi shëndetësor në vend. Sipas deklarimeve të drejtuesve, programet e studimit të ofruara nga UMT bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka rajoni dhe vendi. Referuar të dhënave që u morën gjatë vizitës në institucion FSHMT për vitet akademike 2022-2024 ka në përbërjen e tij, 63 personel akademik efektiv (PAE) i ndarë në tre njësi bazë, si:		
	Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada
	Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në	27	1 – Prof. Dr. 8 – Prof. Asoc. 15 – Dr.

Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji		3- Msc
Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri	21	3– Prof. Dr. 5– Prof. Asoc. 11– Dr. 2 – Dr. në Proc. 0 - Msc
Departamenti i Lëndëve Paraklinike	15	2 – Prof. Dr. 4– Prof. Asoc. 9 – Dr. 0 - Msc
Total	63	63

Referuar të dhënave në dispozicion, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si njësi kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 305 pedagogë, nga të cilët 63 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 242 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e nevojshëm.

Nga sa më sipër, GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit Msc në Teknikë imazherie dhe programet e tjera të kësaj fushe. Fakulteti rezulton të ketë akses të veçantë dhe të drejtpërdrejtë në QSUT dhe spitalet e tjera universitare në vend nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave sipas të cilit ato konsiderohen pjesë integrale e UMT. Fakulteti ka burimet e duhura logjistike për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore, përmes laboratorëve të anatomisë humane, simulimit klinik, informatikës, imazherisë digjitale etj si dhe akses të.

Evidenca nr 2. Rregullore UMT;

Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT;

Evidenca nr 97. Tabelat përmbledhëse;

Evidenca nr 165. Te dhëna statistikore për personelin akademik PAE, PAK, administrativ UMT;

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Teknikë Imazherie, është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të FSHMT. Programi i studimit MSc.Teknikë imazherie, përgatit studentët me njohuritë e avancuara në fushën e imazherisë, e radioterapisë dhe shkencat e shëndetit në tërësi. Programi është organizuar dhe ofrohet në përputhje me udhëzimet dhe aktet nënligjore në fuqi. Një pikë e fortë rezulton të jetë orientimi i institucionit vetëm në fushën e mjekësisë. Programi i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe ka kodin e vet të përcaktuar nga ana e institucionit. Evidenca nr 1. Statuti UMT, Takimi me drejtuesi te fakultetit; Evidenca nr 170. Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 55.1. Lista e kodeve te programeve UMT;
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Edhe fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe departamentit DRSHIKIOGJ që jep kontributin kryesor në këtë program studimi. Fusha e përgjithshme është ajo e mjekësisë e cila është fusha kryesore e institucionit ndërsa fusha specifike lidhet me drejtimin e diagnsotikës. GVJ konstaton se referuar procedurës së ndjekur nga ana e institucionit për klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, ato janë në përputhje me aktet e miratuara dhe ISCED. Evidenca nr 1. Statuti UMT; Evidenca nr 170. Plani Strategjik I Zhvillimit të UMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 55.1. Lista e kodeve te programeve FSHMT;
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohe	N / A

nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ka themeluar një njësi të posaçme që merret me trajnimet profesionale. UMT bashkëpunon ngushtë me rrjetin spitalor universitar, rrjetin shëndetësor jo universitar, urdhrat profesionale në fushën e mjekësisë, Qendren e edukimit në vazhdim, këshillat studentorë dhe me aktorë të tregut të punës dhe bashkë organizon me këto institucione aktivitete të formimit në vazhdim, të cilat u vijnë në shërbim të gjithë profesionistëve për të plotësuar njohuritë e të mësuarit gjatë gjithë jetës Evidenca nr 116. Projekti i Qendres së Biosimulimit klinik dhe Edukimit në vazhdim UMT; Evidenca nr 146. Shërbimet e Telemjekësisë, Takimi me stafin akademik dhe mbështetës;			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit MSc. Teknikë imazherie dhe programet e tjera të kësaj fushe. Programi i studimit Master i shkencave Teknikë imazherie, përgatit studentët me njohuritë e nevojshme profesionale në fushën e imazherisë, e radioterapisë. GVJ konstaton se procedura e klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, ato janë në përputhje me aktet e miratuara dhe ISCED</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, statutin dhe rregulloren e UMT, si dhe aktet rregullatore specifike, po ashtu dhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në

frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	institucion, dhe konstaton se UMT siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UMT ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës. Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren e tij. Nga vlerësimi rezulton se FSHMT, menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Teknikë Imazherie" i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite. Një nga pikat më të forta të FSHMT dhe institucionit në tërësi është roli që ka në formimin e profesionistëve të fushës së mjekësisë. Gjatë takimeve u theksua roli që ka patur UMT në përballimin e pandemisë Covid 19 ku pothuaj i gjithë stafi i UMT ka patur një rol në një nga strukturat spitalore ose të shërbimit. Kjo e bën UMT të përfshirë në mjaft politika dhe të ketë rol drejtues në realizimin e strategjive në fushën e shëndetësisë. UMT drejton dhe koordinon veprimtari në fushën e shëndetësisë, kërkimit, projekteve etj. Ndërkohë ka një bashkëpunim të gjërë me institucionet e tjera në arsim dhe shëndetësi. Edhe brenda FSHMT u evidentua një marrëdhënie konstruktive bashkëpunimi ku në rastin konkret edhe pse programi administrohet nga departamenti DDRSHIKIOGJ, të gjitha strukturat kontribuojnë në zhvillimin me sukses të programit të studimit. Takimi me drejtuesit, Takimi me stafin akademik; Evidenca nr 144.VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare;
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ konstaton se UMT ka një rrjet bashkëpunorësh të gjërë brenda dhe jashtë vendit. Rendësi në zhvillimin e programit ka bërja pjesë e strukturave spitalore universitare. Nga ana tjetër prezenca fizike e FSHMT në mjediset e QSUT mundëson bashkëpunim dhe efikasitet në zhvillimin e veprimtarive mësimore, veçanërisht të praktikave profesionale ku studentët e programeve të FSHMT janë në kontakt të vazhdueshëm me shërbimet e QSUT. Gjithashtu bashkëpunime të vazhdueshme, UMT dhe FSHMT kanë me institucionet shëndetësore private si spitale, klinika etj

	Evidenca nr 49. Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione te tjera; Evidenca nr 46. Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS; Evidenca nr 101. Lista e bashkëpunime me institucione te tjera FSHMT;
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në takimin me drejtuesit dhe personelin akademik, u evidentua se FSHMT ka avantazh të madhe në mundësitë që u oforhen studentëve në zhvillimin e praktikave profesionale. Përveç strukturave spitalore, avantazh përbën fakti që pothuaj i gjithë stafi është i angazhuar në aktivitet privat ose në institucione të tjera private duke mundësuar në këtë mënyrë kontakt të drejtpërdrejtë për studentët në zhvillimin e praktikave profesionale. FSHMT ka gjithashtu bashkëpunime të ngushta me institucione të arsimit të lartë, institute kërkimore si p.sh Instituti i shëndetit publik, Urgjenca kombëtare, kompani që ofrojnë pajisje spitalore, laboratorike e diagnostike për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit si dhe trajnime të ndryshme etj. GVJ e konsideron si pikë të fortë nivelin e bashkëpunimit institucional dhe të programit veçanërisht në zhvillimin e praktikave profesionale. Evidenca nr 49. Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione te tjera; Evidenca nr 46. Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS; Evidenca nr 30. Konferenca vjetore v.2023 FSHMT në bashkëpunim me UV dhe UISH;
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Fakulteti bashkëpunon me partnerët e vet, Urdhrin e Infermierit, Shoqatën Kombëtare e Profesionistëve Shqiptarë, Urdhërin e mjekut, etj, të shërbejë zhvillimit me cilësi të programit të studimit. Drejtuesit deklarojnë se kryejnë analizën e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit. Evidenca nr 79.1. Raport vjetor UMT v.2020-21; www.fshm.edu.al
Konkluzione	<i>FSHMT ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore vendase dhe të huaja, Urdhrin e Infermierit, Shoqatën Kombëtare e Profesionistëve Shqiptarë, Urdhërin e mjekut, etj në</i>



	<i>kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. GVJ e konsideron si pikë të fortë nivelin e bashkëpunimit institucional dhe të programit veçanërisht në zhvillimin e praktikave profesionale dhe hulumtimeve shkencore që kryejnë studentët gjatë zhvillimit të temave të diplomave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatorë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit, është i organizuar në lëndë lëndë dhe module, sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, të ndryshuar si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë. Veprimtaria e ofrimit të programit është bazuar në rregulloren e fakultetit dhe rregulloren e programeve master. Programi është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Në total, në program përfshihen 17 module së bashku me tezën e provimit, me një numër total prej 120 kreditesh. Bazuar në planin mësimor, lëndët bazë, karakterizuese, specifike etj, i japin studentit njohuritë e nevojshme për profesionin e teknikut të imazherisë. Në takimin me personelin akademik, u theksua se përmbajtja e programit është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. GVJ e konsideron faktor pozitiv organizimin e

	programit në përputhje me nevojat që ka vendi dhe eksperiencat ndërkombëtare. Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 6. Rregullore departamenti; Evidenca nr 90. Plan mesimor MSC. Teknike imazherie; Evidenca nr Takimi me stafin akademik, Takimi me studentët;
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në planin mësimor, programi është strukturuar me 17 module me 104 kredite në total dhe 16 kredite teza e diplomës u japin studentëve formimin e nevojshëm teorik, praktik e shkencor për teknikun e imazherisë me njohuri të avancuara në këtë fushë. Temat e parashikuara në planin mësimor, mundësojnë formimin e shprehive të veçanta në imazheri, jep njohuri të përparura në mjekësi dhe garantojnë aftësi dhe kompetenca të përparura në mjekësinë diagnostike dhe ekzaminim shkencor. Në përmbajtje, programi garanton avancimin në karrierë në programet e ciklit të dytë master profesional dhe master shkencor të cilat ofrohen nga vetë fakulteti. Ne gjykojmë se programi është konsoliduar duke garantuar të diplomuar me përgatitjen e nevojshme profesionale e shkencore në të aftë të shërbejnë në institucione publike e private të vendit ose jashtë Evidenca nr 91. Plan mesimor; Evidenca nr 92. Syllabuset e lëndëve dhe moduleve; Takimi me drejtuesit, Takimi me stafin akademik; Evidenca nr 86. Programi i studimit;
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të	Programi është organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 2 vite studimi / 4 semestra, me 120 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup-lëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor. Referuar planit mësimor të studimit programi përmban 18 lëndë, së bashku me praktikën, respektivisht: praktika 1 me 4 kredite, praktika 2 me 8 kredite dhe mikroteza me 16 kredite. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë

detyrimeve përmbyllëse.	strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore. GVJ konstaton se edhe pse programi është i nivelit master shkencor, ai përmban kredite për praktikën profesionale pasi në shumicën e lëndëve janë parashikuar edhe praktikat lëndore duk e çuar numrin total të krediteve në 16, e përafëruar atë me direktivat evropiane për profesionet e rregulluara Evidenca nr 91. Plani mesimor; Takimi me stafin, Takimi me studentët; Evidenca nr 92. Syllabuset e lëndëve dhe moduleve;
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimit i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku	N / A

80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Organizimi i veprimtarive akademicke, pranimi i studentëve etj realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe udhëzimet e MAS. Bazuar në informacionin e dhënë, programi i studimit Master i Shkencave në Teknikë imazherie, reflekton përmbajtje të ngjashme në nivelin e kërkuar 70%. Për shkak të fushës mjekësisë, zhvillimi dhe përmirësimi i programit bëhet gjithahstu edhe në përputhje me direktiva, dokumente apo akte të tjera të nxjerra nga Urdhëri i infermierit. Evidenca nr 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë; Evidenca nr 2. Rregullore e UMT;
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 përqind.	Bazuar në Udhëzimin e MAS Nr. 31. 15. 01. 2022, për “Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti i Mjekësisë ka vendosur kodifikimin e programeve që oforn në fushën e vet. Duke marrë në konsideratë këto përcaktime, programi i studimit MSc në Teknikë imazherie, reflekton përmbajtje të ngjashme në nivelin e kërkuar 70 % edhe pse në nivel kombëtar, numri i programeve master në këtë drejtim është i ulët. Evidenca nr 55.1. Lista e kodeve te programeve UMT; Evidenca nr 96. Plani mesimor MSc. Teknike imazherie; Evidenca nr 56. Procedura, afatet dhe dokumentacioni per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodic te planeve;
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet	Kodi i programit i vendosur në Universitetin e Mjekësisë me Vendim Senati, është 72MS0914S. Kodifikimi është bërë bazuar në Udhëzimin Nr. 31. të MAS duke reflektuar në të elementët e nevojshëm. Programi është pjesë e ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve organizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale 1 (një) vit akademik me kohë të plotë.

kodifikimi i lëndëve të programit.	Evidenca nr 55.1. Lista e kodeve të programeve FSHMT;			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N / A			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi, Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë" si dhe VKM Nr.41 të datë 24.01.2018, të ndryshuar, si dhe akte të brendshme të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe	UMT, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.03, datë 27.01.2023 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, deri në 26.01.2029. FSHMT, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:

strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji;
2. Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri;
3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike;

FSHMT si njësi përgjegjëse për programin e studimit, për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij gjithsej 305 staf akademik, nga ku 63 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 242 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada
Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji	27	1 – Prof. Dr. 8– Prof. Asoc. 15 – Dr. 3- Msc	95	1 – Prof. Dr. 0– Prof. Asoc. 20– Dr. 4 – Dr. në Proc. 70- Msc
Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri	21	3– Prof. Dr. 5– Prof. Asoc. 11– Dr. 2 – Dr. në Proc. 0 - Msc	130	0– Prof. Dr. 5– Prof. Asoc. 16– Dr. 5 – Dr. në Proc. 104 - Msc
Departamenti i Lëndëve Paraklinike	15	2 – Prof. Dr. 4– Prof. Asoc. 9 – Dr. 0 - Msc	17	0– Prof. Dr. 1– Prof. Asoc. 3 – Dr. 2 – Dr. në Proc. 11 - Msc



	<table><tr><td>Total</td><td>63</td><td>242</td></tr></table>	Total	63	242
Total	63	242		
	Në takimin me drejtuesit u theksua se përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është fakulteti ndërsa të gjitha njësitë bazë dhe strukturat e tjera kontribuojnë në realizimin me sukses të tij. FSHMT është njësi e konsoliduar dhe përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike dh epersonelin akademik. Cdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku shumica prej tyre janë me gradë shkencore Prof, Prof.As dhe Dr. Sikundër shihet fakulteti përmbush a detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, ngarkesën, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lëndës me përgjegjësin e saj. GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka kualifikimet e duhura të cilat përputhen me profilin e programit të studimit. Evidenca nr 97. Tablelat me statistikat permbledhese; Evidenca nr 80- 81- 82. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Takimi me drejtuesit e FSHMT; Evidenca nr 96.Cv e personelit akademik; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve;			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike angazhon në ndihmë të procesit akademik, në total 9 personel ndihmës akademik të ndarë në njësitë bazë si vijon: - 3 personel në Departamentin e Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; - 3 personel në Departamentin e Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; - 3 personel në Departamentin eLëndëve Paraklinike; Në programin e studimit angazhohen dhe teknikë imazherie si mbikqyrës të praktikave profesionale që aktualisht janë staf i QSUT ose në qendra të tjera diagnostike. Kjo konsiderohet mjaft			

	pozitive nga ana e GVJ pasi shërben për transferimin e eskepticencës nga profesionistët tek studentët Evidenca nr 97. Tablelat me statistikat permbljedhese; Evidenca nr 80- 81- 82. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Takimi me drejtuesit e FSHMT; Evidenca nr 96.Cv e personelit akademik; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Takimi me stafin akademik;
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinаторit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në RVB, programi i studimit ofrohet në nivel fakulteti dhe për realizimin ndjekjen dhe zhvillimin e veprimtarive akademike dhe praktikave profesionale kanë përgjegjësi të tre njësitë bazë të fakultetit, megjithatë programi i është deleguar DRSHIKIOGJ. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë akademik për departamentin. Detyrat dhe kompetencat e tij janë të drejtë punën për hartimin e planeve mësimore dhe programeve të lëndëve që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre, ndjek dhe kontrollon aktivitetin shkencor në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktiviteti shkencor dhe akademik të anëtarëve të departamentit. Fakulteti nëpërmjet Drejtuesit të Departamenteve cakton çdo vit një person në rolin e koordinаторit të programit të studimit i cili sikundër u theksua në takimet me personelin akademik është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht drejtuesin e fakulteti qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera që realizohen gjatë vitit akademik. Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 6. Rregullore departamenti;
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave Mjeksores Teknike dhe Departamenti DRSHIKIOGJ, përgjegjës për programin e studimit, janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. GVJ konsideron pikë të fortë përfshirjen e personelit akademik të kualifikuar dhe veçanërisht ata të angazhuar në strukturat spitalore përfshirë këtu edhe teknikët e imazherisë.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore FSHMT përgjegjëse për programin e ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Teknik Imazherie”, disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor. Një kopje e dokumentacionit gjendet edhe në njësitet bazë. Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar dhe ka respektuar kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, e ndryshuar. Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 91. Plani mesimor; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve;
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit të studimit është organizuar në përputhje me VKM 41 të ndryshuar. Edhe syllabuset e lëndëve janë përshtatur në përputhje me VKM Nr. 41 duke pasqyruar të gjithë elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi. Çdo vit akademik përmban një numër të caktuar lëndësh / modulesh që nuk kalojnë numrin e provimeve të përcaktuar në aktet rregullatore në total janë 18 lëndë me shpërndarje rreth 7-9 lëndë për vit akademik në ndarjen e krediteve është ruajtur raporti i përcaktuar me VKM. Për përmbajtjen e programit, studentët informohen të javës së parë të fillimit të citit akademik duke u vënë në dispozicion të studentëve edhe “Manualin e studentit”. Evidenca nr 90. Plani mesimor MSc imazheri; Evidenca nr 107. Manuali i keshillimit të karrierës; Evidenca nr 123. Shembull Broshure Informuese për studentet;

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e UMT, FSHMT dhe në atë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve të cilat zhvillohen në përputhje me aktet nënligjore të shpalluar nga MAS. Institucioni ka parashikuar procedurën që si kryhen transferimet e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes, transferimi i studimeve, transferimi i studimeve në të njëjtin cikël studimi, procedurat e transferimit, si dhe ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen. Evidenca nr 5. Rregullore fakulteti; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 3. Rregullore UMT;
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në programin e studimit, syllabuset në përgjithësi përmbajnë informacionet e nevojshme për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Ato janë përshtatur në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar duke pasqyruar të gjithë elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi. Syllabet përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikën, seminarët, orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. <i>Megjithatë në ndonjë rast GVJ identifikoi syllabuse që kanë nevojë të përditësojnë literaturën bazë dhe ndihmëse.</i> Për nga natyra e programit master shkencor, ka rëndësi realizimi i studimeve dhe kërkimeve individuale nga studentët. GVJ konstaton në këtë drejtim, se fakulteti ka mundësi të shumta për shkak të përkatësisë së qendrave spitalore si pjesë UMT duke u ofruar studentëve mundësi të shumta për zhvillimin e praktikave. Evidenca nr 92. Syllabuset e lëndëve; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 13. Ditari i praktikës profesionale FSHMT;

Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në takimin me personelin akademik u deklarua se procesi i përmirësimit të programit të studimit inicohet me Urdhër të Rektorit i cili kërkon në përfundim të çdo viti akademik që fakultetet dhe departamentet e universiteti të kryejnë ndryshime eventuale në programet e studimit nën masën 20 %. Çdo departament propozon ndryshimet e nevojshme duke i argumentuar dhe dokumentuar të gjithë procedurën. Në 3 vitet e fundit programi nuk ka patur ndryshime ndërkohë syllabuset janë në përmirësim të vazhdueshëm. Evidenca nr 11. Praktike për miratimin e planeve mesimore; Evidenca nr 91. Plani mesimor MSc. Teknike imazheri;			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është i organizuar dhe i strukturuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1 shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018 të ndryshuar duke reflektuar përmbushjen e objektivave formuese të programit të ciklit të dytë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Plani mësimor i programit është i përbërë nga leksione, seminare, laboratorë dhe praktika. Shpërndarja dhe emërimi i lëndëve, sipas kategorive, në lëndë bazë, karakterizuese ndërdisiplinore, plotësuese dhe formuese, japin mundësi në thellimin e njohurive dhe aftësive praktike për punësim, ose studime të mëtejshme. Programi i studimit ofron praktika laboratorike/lëndore dhe profesionale për përfitimin e aftësive të nevojshme për teknikun e imazherisë. Elementët e programit janë leksione, seminare, praktika, laboratorë si dhe kontrolli i vazhdueshëm. Ngarkesa mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo

	lëndë/modul, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila lëndë Evidenca nr 86.1, 86.2, 86.3 Programi i studimit; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 49. Lista e bashkepunimeve; Evidenca nr 118. Infrastruktura ne funksion te mësimdhënies;
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi i studimit është i organizuar në 2 vit, 4 semestra, 120 kredite. Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorët si Urdhri i infermierit, shoqata të ndryshme, studentë të diplomuar etj. GVJ konstaton se institucioni reflekton propozimet që janë të vlefshme në kuadër të përmirësimit të programit si edhe në drejtim të kërkimit shkencor duke marrë në konsideratë nevojën që kanë qendrat spitalore me avancimin e teknologjisë në fushën e diagnostikës. Evidenca nr 92. Syllabueset e lëndëve; Evidenca nr 86.1, 86.2, 86.3 Programi i studimit; Evidenca nr 13. Ditari i praktikës profesionale_FSHMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit, Evidenca nr 21. Rregullore programi;
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përafrimin e përmbajtjes së programit në përputhje me kërkesat që parashikojnë direktivat evropiane. Sipas deklarimeve të institucionit, ndryshimet kryesore kanë qënë në vitin akademik 2019 e më pas programi i studimit është konsoliduar vit pas viti duke reflektuar eksperiencën shumëvjeçare, rekomandimet që japin studentët e diplomuar veçanërisht ata jshtë vendit. GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit ofron mundësi për thellimin e njohurive, teorike, praktike, shkencore dhe avancimin në studimet e ciklit të tretë të studimeve. Evidenca nr 97. Tabelat me Statistika; Evidenca nr 109. Analize vjetore; Evidenca nr 108. Aktivitete te zyres se karrieres; Evidenca nr 184. Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për student;

	Evidenca nr 86. 86.1, 86.2, 86.3 Programi i studimit;
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Struktura e programit është në funksion të objektivave të përcaktuara në rregulloren e programit. Ndarja e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike. Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorët si Urdhri i infermierit, shoqata të ndryshme, studentë të diplomuar. GVJ konstaton se lëndët dhe raporti i tyre është përcaktuar në përputhje me aktet ligjore, duke synuar njëkohësisht arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim e avancim në karrierë në përfundim të studimeve të ciklit të dytë Evidenca nr 11. Praktike për miratimit e planeve mesimore; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 86.1, 86.2, 86.3 Programi i studimit;
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në takimin me personelin akademik, u konstatua se programi i studimit dhe syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me kërkesat e tregut të punës, Bazuar në mendimet e marra merren masa për zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe syllabuset. GVJ vlerëson angazhimin e personelit akademik për të përgatitur materiale didaktike të viteve të fundit në formën e prezantimeve dhe cikleve të leksioneve. Nevoja për përditësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së lëndëve lidhet me faktin se Teknologjia e pajisjeve radiologjike dhe metodat e ekzaminimit diagnostike përmirësohen vazhdimisht. Veçanërisht në lëndët në të cilat teknologjia avancohet në mënyrë të shpejtë si Teknikat e rindërtimit 3D, Radioterapi e avancuar dhe dozimetri, Teknikat fusioin e imazheve mjekësore, rezultojnë të jenë në përditësim të vazhdueshëm. Takimi me stafin; Takimi me studentet; Evidenca nr 92. Syllabuset;
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve,	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, bazuar në objektivat e programit të studimit, synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e diagnostikës: njohuri të avancuar në fushën e mjekësisë, aftësi praktike, përgjegjësi individuale dhe

aftësive dhe kompetencave të synuara.	për të tjerët. Lëndët pjesë e programit mbulojnë spektrin: formimin bazë shëndetësor/ paraklinik, formim specifik diagnostik, formimin klinik, formin trajtimi në radioterapi. GVI konstaton përditësimi i syllabuseve administrohet nga drejtuesit e departamenteve të cilët njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Takimi me stafin; Takimi me studentet; Evidenca nr 92. Syllabuset; Evidenca nr 80-81-82. Raporte FSHMT; Evidenca nr. 84-85. Analiza DDRSHIKIOGJ;			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës, dhe shërbimet shëndetësore.Referuar RVB, përmbajtja e programit, syllabuseve, përshtatja sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, kryhet nga departamentet përgjegjëse. Gjatë periudhës së propozimeve, merren parasysh propozimet e tyre, studentëve, bashkëpunëtorëve dhe partnerëve që janë pjesë e tregut te punës. Studentët e diplomuar në këtë program studimi rezultojnë të jenë nga më të kërkuarit në tregun e punës. Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 80-81- 82. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 15. Aktivitete me student; Takimi me studentet;			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit 6 sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në programin e studimit janë angazhuar personel akademik i cili njëkohësisht është pjesë e qendrave më të mëdha spitalore në vend. GVJ vlerëson këtë tregues si mjaft të dobishëm pasi vetë stafi akademik transferon në mënyrë të drejtpërdrejtë mendimin dhe kërkesat e tregut të punës. Anëtarë të stafit si dhe partnerët e tjerë gjatë vlerësimit të ecurisë së programit të studimit, janë kontrakti i drejtpërdrejtë me tregun dhe fakultetin si ofrues i programit. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet në drejtuesit e departamenteve të cilët njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Evidenca nr 97. Statistika; Evidenca nr 165. Te dhena statistikore per personelin akademik PAE, PAK, administrativ UMT; Evidenca nr 11. Praktike per miratimit e planeve mesimore;
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimi me studentet GVJ evidentoi se FSHMT nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Përfshirja si perosnel akademik të studentëve të diplomuar që aktualisht është pjesë e strukturave spitalore universitare, është mjaft e dobishme pasi ata sjellin eksperiencën e tyre mbi programin e studimit dhe nevojën që ai ka për përmirësime të mundshme, ndërkohë bashkëpunimi me Këshillin studentor është i vazhdueshëm. Këta studentë janë shumë mirë të informuar jo vetëm mbi përmbajtjen e programit por ata janë masivisht njohës të gjuhëve të huaja dhe përdorues të teknologjisë çka u jep mundësi të lundrojnë në internet, të krahasojnë programe në institucione të ndryshme dhe të shprehin mendime, për këtë arsye pritshmëritë dhe kërkesat e tyre. Metodë tjetër janë pyetësorët e studentëve ku në disa pyetje atyre u kerkohet të shprehin për të përmiresuar me tej programming e studimit.

	Evidenca nr 67. Shembull Pyetesor -Vleresim i studenteve per lendet e programit te studimit_formular; Evidenca nr 96.CV-te e personelit akademik te angazhuar; Evidenca nr 24.Lista e aktiviteve Këshilli Studentor; Evidenca nr 62. Pyetesor mbi perdorimin e pajisjeve teknologjike nga studentet; Evidenca nr 27. Pyetesori i studenteve ne FSHMT; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetesorit te studenteve;			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti si njësia bashkëofruese për programin e studimit, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera bëjnë propozimet e tyre dhe përditëson, përshtat programin e studimit, në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushën e diagnostikës. Bashkëpunimi është i zgjeruar edhe me profesionistët e shëndetit, shoqata e profesionistëve të mjekësisë, urdhërin e infermierit dhe urdhërin e mjekut etj. Sikundër është theksuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit dhe stafin akademik, angazhimi i tyre në institucionet shëndetësore, ka ndihmuar gjithashtu institucionin të sjellë eksperiencat më të mira dhe të reflektojnë në programin e studimit eksperiencat të ndryshme që vijnë nga aplikimi real i njohurive në sistemin shëndetësor të vendit. Evidenca nr 46. Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS; Evidenca nr 49. Lista e bashkëpunimeve me IAL; Evidenca nr 97. Lista e personelit akademik; Evidenca nr 96.CV e personelit akademik;			
Konkluzione	<i>Fakulteti nxit përfshirjen e studentëve dhe IAL me të cilët ka marrëveshje, si dhe institucionet e kujdesit shëndetësor, në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Prioritet i programit të studimit është formimi i studentëve të aftë për të qënë kompetent në fushën e tyre. Programi përcakton qartë prioritetet dhe përgjegjësitë në menaxhimin e situatave komplekse jo vetëm si profesioniste por objektivat kryesorë të studimit dhe edhe me vlera të larta humane. Misioni i këtij program studimi është përgatitja e specialistëve / profesionisteve teknikë me njohjen dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në klinika spitalore, poliklinika, shtëpi kujdesi, etj. Në organizimin e punës në drejtim të rritjes së kosto-efektivitetit të tyre, përdorimin më të mirë të burimeve njerezore, minimizimin e gabimeve mjekesore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor që i ofrohet pacientit me gjithë gamen e ekzaminimeve. Ky program studimi ka për objektiv t'u japë pjesmarrësve aftësi profesionale në fushën e imazherisë. Programi ka për objektiv të rrisë kompetencat profesionale nepërmjet njohjes më të plotë të protokolleve të punës në sallë, interpretimin diagnostik të analizave dhe përshtatjen bashkëkohore me teknologjine e kohës. Kërkimi shkencor është një objektiv po ashtu kryesorë e këtij programi studimi. Evidenca nr 90. Plani mësimor; Evidenca nr 92. Sylabusët; Evidenca nr 97. Statistika; Evidenca nr 165. Te dhena statistikore për personelin akademik PAE, PAK, administrativ UMT; Evidenca nr 11. Praktike për miratimit e planeve mesimore;
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit	Fakulteti realizon kërkim shkencor në bazë të fushës së vet si dhe duke respektuar etikën në kërkimin shkencor. Pedagogët e FSHMT kanë liri në mësimdhënie si dhe në veprimtari kërkimore shkencore. Departamenti organizon dhe administron procesin akademik duke nxitur, bashkërenduar dhe respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturës etj. Dekani i Fakultetit ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit



akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	të programit. Shpërndarja gjatë vitit akademik e orëve të teorisë dhe projekteve kerkimore dhe praktikave bën të mundur ndërthurjen e dijeve dhe siguron mundësinë për të respektuar lirinë akademike të pedagogut, duke ndihmuar studentët në mbledhjen e të dhënave klinike për të prezantuar raste konkrete të hasura në fushën e studimit, në projektet e tyre lëndore. Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 80- 81- 82. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 15. Aktivitete me student; Takimi me student; Evidenca nr 96.CV-te e personelit akademik te angazhuar;
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kerkimore.	FSHMT nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe workshope si dhe të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kerkimore, nëpërmjet detyrave të kursit, dhe hartimit të temave të ndryshme kerkimore. Sipas rregullores së Fakultetit, studenti ka të drejtë të përdorë, sipas rregullave përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron IAL për të realizuar programin mesimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor. Paralelisht, studentët e këtij program studimi kanë të drejtë të përdorin pajisjet e institucionit sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre mësimor, professional etj. Produktet shkencore të studentëve, si dhe temat e kursit, depozitohen në menynë elektronike dhe të printuar pranë Fakultetit dhe shërbejnë si të dhëna kerkimore dhe nga ana tjetër, pedagogët i kanë nxitur studentët t'i botojnë këto punime, i kanë përfshirë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombetare. Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore e departamentit; Evidenca nr 82-83- 84. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 15. Aktivitete me student; Takimi me student; Evidenca nr 96.CV-te e personelit akademik te angazhuar;
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kerkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet	Institucioni referon se mbështet financiarisht aktivitetet studimore, kerkimore e shkencore në bazë të buxhetit të miratuar. Organizimi i konferencave është një metodë e mbështetjes së këtyre aktiviteteve. Në takimin me stafin akademik u theksua se

financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	kanë marrë mbështetje financiare nga Institucioni për pjesmarrje në konferenca ndërkombëtare ose për publikim artikulli shkencor. Njësia kryesore mbështetet financiarisht nga institucioni dhe ajo nuk administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore e departamentit; Evidenca nr 82-83-84. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 15. Aktivitete me student; Takimi me studentet, 96.CV-te e personelit akademik te angazhuar;			
Konkluzione	<i>Prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë. Njësitë realizojnë kërkim shkencor në bazë të fushës së vet si dhe duke respektuar etikën në kërkimin shkencor. Studentët përfshihen në aktivitete kërkimore shkencore ndërsa stafi raporton mbështetje financiare për kërkimin shkencor</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni referon se mbledhja e të dhënave kërkimore të studentëve në funksion të detyrave lëndore mbështet projektet e lëndëve dhe që plotësojnë kuadrin e objektivave të masterit. Projektet kërkimore-shkencore kryhen në struktura mbështetëse dhe departamente të tjera dhe që sigurojnë bashkëpunimin me strukturat e tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Këto të dhëna pedagogët referojnë se studentët mund ti mbledhin në qendrat spitalore me të cilat institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi. Nga diskutimi u raportua se FSHMT ka projekte kërkimore të financuara nga AKKSHI dhe nga burime Europiane.

	Evidenca nr 15.Aktivitete studente libri i abstrakteve konferenca e shkencave mjekesore; Evidenca nr 45.Lista e projekteve kombetare te aplikuarra dhe te fituara;
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	FSHMT angazhohet për të lidhur dhe për t'iu përgjigjur marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore, kërkesave për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor. Personeli akademik realizon modele bashkëpunimi afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata. Njësia bashkëpunon po ashtu edhe me Institucione homologe me qëllim kërkimin shkencor. Pedagogë të huaj marrin pjesë në mësimdhënie si dhe organizojnë leksione të hapura. Këto aktivitete rrisin mundësitë e zhvillimit të kërkimit shkencor. Paralelisht, Njësia inkurajon pedagogët të marrin pjesë në mobilitete afatshkurtra jashtë vendit përmes programit Erasmus+. Përmes këtij programi një numër i konsiderueshëm i stafit akademik ka zhvilluar mobilitete jashtë shtetit gjë që i ka ndihmuar ata në aktivitetin kërkimor. Aplikime në projekte kërkimore shkencore me partner të brendshëm dhe të huaj u raportua nga Drejtuesit e FSHMT se janë zhvilluar. Evidenca nr 15.Aktivitete studente libri i abstrakteve konferenca e shkencave mjekesore; Evidenca nr 45.Lista e projekteve kombetare te aplikuarra dhe te fituara; Evidenca nr 38.Shembull Propozim projekti laboratorimazherise dixhitale;
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Imazheria është një nga drejtimet e rëndësishme të mjekësisë ku universiteti dhe fakulteti realizojnë dhe marrin pjesë në veprimtari kërkimore GVJ ka evidentuar se institucioni mbështet realizimin e konferencave ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale si dhe organizon aktivitete të ndryshme të cilat ndihmojnë personelin akademik dhe studentët. Studentët kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme trajnuese ndërsa personeli ka mundësinë të marrë pjesë në leksione të hapura si dhe aktivitete të ndryshme. Disa manuale dhe udhëzues janë hartuar për të mbështetur stafin në hartimin e projekteve dhe aplikimeve

	Evidenca nr 45. Lista e projekteve kombetare te aplikuar dhe te fituara; Evidenca nr 38. Shembull Propozim projekti laboratorimazherise dixhitale;
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	GVJ konstaton se programi i studimit krijon mundësi për studentët të fitojnë aftësi konkurrues për një gamë të gjerë të patologjiave me të hasura klinike duke i bërë ata të aftë për tregun kombëtar dhe të përshtatshëm të punojnë në çdo qëndër shëndetësore dhe gjithashtu të synojnë edhe tregun ndërkombëtar të punës. Një pjesë e punonjësve të spitalit janë alumni të FSHMT ndërsa një pjesë kanë emigruar jashtë Shqipërisë. Evidenca nr 167. Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore UMT; Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetore FSHMT;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programet e fushës së mjekësisë përfshihen në listën e profesioneve të rregulluara. Në takimin me drejtuesit e fakultetit, u theksua se të gjitha programet e studimit që fakulteti ofron janë pjesë e kësaj liste. Për rrjedhojë fakulteti ka bashkëpunim të ngushtë me Urdhërin e infermierit. Personeli akademik i fakultetit është pjesë e pandarë e komisioneve të ngritura nga urdhëri për testimin e praktikës profesionale dhe provimin e shtetit. Në këtë mënyrë, ne konstatojmë se fakulteti duke qenë se është në kontakt të vazhdueshëm, merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhëri i infermierit, në mënyrë që në programin e studimit të reflektohen propozimet dhe nevojat që kanë qëndrat spitalore. Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetore FSHMT; Takimi me drejtuesit, Takimi me stafin;
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në diskutimin me përfaqësuesit e departamentit dhe zyrës së kurrikulave u evidentua përpjekja e vazhdueshme që ka bërë fakulteti për të përmirësuar raportin midis formimit teorik dhe atij praktik. GVJ konstaton se programi i studimit aktualisht përputhet me aktet ligjore në fuqi por janë bërë ndryshime të vazhdueshme për tu përafëruar dhe me rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh., 2005/36/EU). Në dhjetor 2023, është ndryshuar VKM 41, e cila sipas drejtuesëve të fakultetit, do të ndihmojë në përafrimin

	e programeve të studimit me ato evropiane përsa i përket raportit teori – praktikë Takimi me drejtuesit, Takimi me personelin akademik;			
Konkluzione	<i>Aktivitete kërkimore shkencore zhvillohen ndërsa FSHMT angazhohet për të lidhur dhe për t'iu përgjigur marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore. FSHMT mbështet realizimin e konferencave dhe aktiviteteve kërkimore ndërsa të diplomuarit janë konkurrues për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Programi aktual zhvillohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi por njëkohësisht ka marrë në konsideratë edhe nevojën për përshtatjen e tij në përmbushje të direktivave evropiane</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e	Në takimin me personelin akademik u evidentua se fakulteti përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, transmetimit të dijeve e njohurive sikundër janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura etj. Procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike të realizohen në përputhje me Rregulloren e fakultetit dhe rregulloren e programit duke respektuar lirinë akademike. GVJ konstaton se

hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	metodat e transmetimit të njohurive tek studentët zhvillohen në varësi të llojit të veprimtarive formuese dhe llojit të lëndëve. Format e shumëfishta të veprimtarive që zhvillohen brenda një lënde, përbëjnë avantazh pozitiv. Takimi me personelin akademik; Evidenca nr 2. Rregullore e Universiteti të Mjekesise; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 123. Shembull Broshure Informuese per studentet FSHMT; Evidenca nr 91. Plani mesimor MSc. Teknike imazherie;
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Çdo syllabus përmban informacionet e nevojshme përfshirë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit të njohurive si leksionet, seminarët, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, punim shkencor etj. GVJ konstaton se stafi akademik është i gatshëm në ofrimin e asistencës përkundrejt studentëve që shfaqin mangësi në kuptimin e lëndës. Ngarkesa mësimore është shpërndarë në mënyrë të tillë që të mundësojë ngarkesë normale gjatë gjithë vitit e përballueshme nga studentët. Stafi respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Evidenca nr 86. Programi i studimit,; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Takimi me personelin akademik;
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UMT mbështet në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe ndihmës akademik. Në mbështetje të personelit akademik, institucioni prej disa vitesh ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. GVJ konstatoi se aktualisht FSHMT ka në përdorim platformen e korrigjimit të provimeve Clean Score në bashkëpunim me AADF. Projekti zbatohet prej disa vitesh në UMT. Pandemia Covid-19 ka ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës dixhitale të institucionit në funksion të organizimit të veprimtarive akademike e administrative dhe



	infrastruktura logjistike që ai përdor. Ndërkohë në përdorim është gjithashtu sistemi Pitagora i sekretarisë mësimore. Evidenca nr 145. Relacion cleanscore FSHMT; Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve; Evidenca nr 40. Nderfaqe sistemi PITAGORA; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden);
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vene në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Pesoneli akademik me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Master Shkencor në Teknik Imazherie, i plotëson kërkesat ligjore përsa i përket numrit, titujve dhe gradave. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit për leksione dhe seminare zotëron titujt dhe grada sipas përcaktimeve ligjore, ndërsa për praktikat dhe ligjore angazhohen personel ndihmës akademik minimalisht të diplomuar në ciklin pasardhës të studimeve Master Shkencor. Me marrëveshjet e siguruara nga UMT, personeli akademik vjen dhe nga struktura të tjera spitalore të sistemit publik dhe privat se nga universitete të tjera. GVJ konstaton se personeli akademik plotëson kriteret ligjore për angazhimin në këtë program studimi. Takimi me personelin akademik; Evidenca nr 91. Plani mesimor MSc. Teknike imazherie; Evidenca nr 97. Tabelat Ankeset; Evidenca nr 122. Shembull Udhëzues i praktikës profesionale; Evidenca nr 96. CV-te e personelit akademik te angazhuar; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe	Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, ku

përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	përmes kontrolleve të vazhdueshme, planit të aktiviteteve të personelit akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera të fakultetit, siç janë sekretaritë e departamenteve, etj, përmirësojnë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Drejtuesi i departamentit përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore, miraton ndryshimet në syllabuse, vlerëson performancën e stafit dhe administron veprimtaritë e departamentit respektojnë lirinë akademike në ofrimin e programit të studimit. Personeli akademik ka hapësirat e nevojshme të implementojë forma të ndryshme të mësimdhënies që i shërbyjnë prograamit të studimit dhe arritjes së objekteve të parashikuara Takimi me drejtuesit; Evidenca nr 150. Permbledhje Manuale EasyWeb; Evidenca nr 74. Vendim Rektorati Per implementimin e platformes online EasyWeb LMS ne UMT; Evidenca nr 149. Pershkrimi i funksionaliteteve te sistemit PITAGORA; Evidenca nr 23. Shembull nderfaqe Googlecalssroom; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb;
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin	GVJ konstaton se UMT ka të konsoliduar sistemin e sigurimit të cilësisë për shkak të eksperiencës së fituar në proceset e akreditimit. Vitin e kaluar UMT zhvilloi procesin e ri akreditimit institucional duke mundur në këtë mënyrë një konsolidim të mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë. NJSBC është njësi përgjegjëse në nivel institucional që promovon përmirësimin e mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkëpunon me njësitë e tjera të UMT në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore e kërkimore dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme. Angazhimi i institucionit dhe njësive përbërëse për garantimin e standardeve të mësimdhënies është maksimal. Zv. Dekani i ngarkuar për pjesën mësimore, sipas një plani të mirë përcaktuar, organizon takime dhe konsultime për zgjidhjen e problematikave të ngritura nga studentët apo dhe pedagogët. Në




akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	takime u deklarua se janë organizuar disa leksione të hapura me ekspertë të fushës për personelin akademik për të përmirësuar aftësitë didaktike dhe përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. Takimi me NJSBC; Evidenca nr 80- 81-82. Raport vjetor FSHMT; Evidenca nr 74. Vendim Rektorati Per implementimin e platformës online EasyWeb LMS ne UMT; Evidenca nr 2. Rregullore UMT; Evidenca nr 149.Trajnime sistemi i mësimdhënies, Pitagora;			
Konkluzione	<i>FSHMT është një nga njësitë më të mëdha e UMT, e konsoliduar dhe me eksperiencë shumëvjeçare. Fakulteti garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Në programin e studimit është angazhuar personel i fushës me eksperiencë shumë vjeçare. Cilësia e mësimdhënies dhe programit në tërësi garantohet nga mekanizmat e brendshëm dhe NJSBC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve për programin e studimit Master i Shkencave në Teknikë Imazherie, përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, në syllabuset e lëndëve dhe në metodikën e zhvillimit të veprimtarive akademike. Këto kritere përfshijnë, vlerësimin e studentit gjatë gjithë vitit me anë të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, punëve laboratorike, praktikave profesionale dhe provimit përfundimtar. Mënyra e vlerësimit jepet në mënyrë të detajuar në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të lëndës. Një pjesë e informacionit është publikuar

	në LMS dhe në faqen e internetit të fakultetit, Informacione jepen edhe në fillim të lëndës ose modulit etj Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 86. Programi i studimit MSc. Teknike Imazherie; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve MSc. Teknike Imazherie, Takimi me studentet;
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo semestri pedagogu përkatës në orën e parë të vitit akademik, i informon studentët mbi përmbajtjen e lëndës, temat që do zhvillohen mënyrën e vlerësimit etj, duke i njohur kështu studentët më syllabusin e lëndës. Gjithashtu në takimin me zyrën e karrierës u deklarua që në FSHMT zhvillohet dita e bluzave të bardha, java e informimit me studentët. Më shumë informacion studentët e gjejnë në syllabuset e lëndëve ku ata informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Evidenca nr 123. Shembull Broshure Informuese per studentet FSHMT; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 124. Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT FSHMT; Evidenca nr 12. Nderfaqe Facebook FSHMT; Evidenca nr 143. Nderfaqe web UMT; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve MSc. Teknike Imazherie, Takimi me studentet;
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës/modulit bëhet sipas modelit të detajuar nga departamenti por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës përcaktimi i peshës specifike për secilin komponent të mësimdhënies (leksione, seminare/ushtime, laboratorë dhe provim përfundimtar. Sipas rregullores së programit të studimit, testimi i dijeve dhe njohurive të studentëve gjatë një semestri ose viti akademik realizohet përmes detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, provimeve të ndërmjetme dhe provimin përfundimtar, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të ndryshme për të shpalosur njohuritë e tyre.




	Për sa i përket provimit përfundimtar ai organizohet sipas specifikave të lëndës dhe në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e departamentit. Provimi përfundimtar zhvillohet me shkrim me bazuar në një set pyetjesh të cilat janë përzgjedhur nga komisioni i diplomës të ngritur nga përgjegjisi i departamentit. Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 67. Pyetesor Vleresim I studenteve per lendet e programit te studimit formular;			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studentëve gjatë procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas rregullores së programit të studimit, testimi i dijeve dhe njohurive të studentëve gjatë një semestri ose viti akademik realizohet përmes detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, provimeve të ndërmjetme dhe provimin përfundimtar, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të ndryshme për të shpalosur njohuritë e tyre. Detyrimet e lëndës bëhen të ditura në fillim të saj si dhe diskutohen gjatë zhvillimit të saj. Provimi përfundimtar organizohet sipas specifikave të lëndës dhe në bashkëpunim me komisionin e provimit. Provimi përfundimtar mund të jetë me shkrim dhe vetëm me pyetje zhvilluese i bazuar në programin e lëndës. Evidenca nr 123. Shembull Broshure Informuese per studentet FSHMT; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 17. Orari mësimor 2023-24;

	Evidenca nr 145. Relacion cleanscore FSHMT; Evidenca nr 61. Procedure ankimi i studentit per vlerësimin;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Aktualisht testimi dhe vlerësimi i njohurive në UMT realizohet nëpërmjet platformës së korrigjimit të provimeve Clean Score në bashkëpunim me AADF. Ndërkohë në përdorim është edhe sistemi Pitagora i sekretarisë mësimore. UMT në mbështetje të personelit akademik, prej disa vitesh ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Evidenca nr 145. Relacion cleanscore FSHMT; Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve; Evidenca nr 40. Nderfaqe sistemi PITAGORA; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb; Takimi me zyrën e shërbimeve mbështetëse;
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në aktet rregullatore, përcaktohen modalitetet e provimit dhe përbërja e komisionit në drejtimin e titullarit të modulit. GVJ konstatoi se përbërja e komisioneve të provimeve është i përbërë nga të paktën 2 persona. Në syllabuset e lëndëve janë dhënë detyrimet e studentëve lidhur me një lëndë/modul. Në provimin përfundimtar, studenti informohet lidhur me formatin e pyetjeve, temat ku studentët fokusohen, literaturën bazë. Studentët mund të kërkojnë orë informimi, apo sqarime të mëtejshme para provimeve. Evidenca nr 61. Procedure ankimi i studentit per vlerësimin; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve; Takim me studentet; Takimi me personelin akademik;
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të	Në kontrollin e dijeve një pjesë të rëndësishme zë puna individuale e studentëve. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimit të



nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	detyrave/projekteve të kursit, punëve të laboratorit dhe u jep këshilla/orientime atyre se si mund të përmirësojnë performancën në të ardhmen. Pas provimit, nëse kërkohet, me qëllim që studenti të jetë jepen sqarime në seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korrigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre. Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve;
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Mjedisi ku zhvillohet testimi monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë, të caktuar me miratim nga Departamenti, dhe që të dy apo më shumë janë përgjegjës për ecurinë e provimit. Pas dhënies së tezës, në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës. Anëtarët e komisionit të provimit të modulit mbikëqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit. Studenti nuk lejohet të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në module të ndryshme. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik, me përjashtim të drejtuesit të Departamentit, të drejtuesit të Fakultetit apo persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani për të asistuar rregullsinë e kryerjes së provimeve. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Studentët deklarojnë se kopjimi nuk lejohet në mënyrë kategorike dhe ndëshkohet. Takimi me drejtuesit; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve;
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Procedura e testimit, kontrollit të dijeve dhe vlerësimit është përcaktuar në rregulloren e programit të studimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin dhjetë nota. Nota kaluese me e ulëta është nota pesë. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit pas 2 javësh dhe pas 1 jave për riprovimet. Pasi studenti ka përfunduar dhe ka shlyer të


	gjitha detyrimet e programit të studimit, ai futet në provimin përfundimtar. Evidenca nr 40. Nderfaqe sistemi PITAGORA; Evidenca nr 149. Pershkrimi i funksionaliteteve te sistemit PITAGORA; Evidenca nr 142. Print screen të shërbimeve të RASH; Evidenca nr 151. Marrëveshje me RASH per sherbime ne fushen e IT;
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ vlerëson metodologjinë e ndjekur nga fakulteti për menaxhimin e procesit të testimit në provime duke garantuar të drejtat e studentët për rishikim të vlerësimit. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit (hedhjes së tyre në sistem) studentët kanë detyrimin e leximit të notës së tyre në sistem dhe të kontestimit të mundshëm brenda periudhës së ankimit. Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem. Evidenca nr 40. Nderfaqe sistemi PITAGORA; Evidenca nr 149. Pershkrimi i funksionaliteteve te sistemit PITAGORA; Evidenca nr 142. Print screen të shërbimeve të RASH; Evidenca nr 151. Marrëveshje me RASH per sherbime ne fushen e IT; Takimi me studentët;
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo studenti i vihet në dispozicion vlerësimi paraprak bazuar në rezultatin e provimit në sistemin e sekretarisë mësimore Mbas kontestimit të notës nga studentët, kërkesa e tyre për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu përkatës i lëndës të cilër më pas vendosin notën përfundimtare dhe e depozitojnë në sekretarinë mësimore. Evidenca nr 40. Nderfaqe sistemi PITAGORA; Evidenca nr 149. Pershkrimi i funksionaliteteve te sistemit PITAGORA; Evidenca nr 142. Print screen të shërbimeve të RASH; Evidenca nr 151. Marrëveshje me RASH per sherbime ne fushen e IT; Evidenca nr 61. Procedure ankimi i studentit per vlerësimin;

Konkluzione	<i>Institucioni ka kuadër rregullator që siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet bazuar në programin e parashikuar në syllabusin e lëndës, dhe kryhet bazuar në rregulloren e programit të studimit. GVJ vlerëson metodologjinë e ndjekur nga fakulteti për menaxhimin e procesit të testimit në provime duke garantuar të drejtat e studentët për rishikim të vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit përmban lëndë dhe module që mundësojnë thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Plani mësimor i këtij program studimi ka lëndë, përfshirë praktikën profesionale dhe provimin përfundimtar, në të cilat studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të teknikave imazherike. Kjo garantohehet nëpërmjet zhvillimit të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 91. Plani mesimor; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Takimi me personelin akademik;
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe	Sikundër kemi evidentuar, programi përmban kredite të alokuara për lëndët e informatikës, vizualizimit të imazheve mjekësore, teknikave të simulimit klinik etj, që janë në gjykimin tonë lëndë me inters dhe që kanë rëndësi në aftësimin profesional në teknologjinë e informacionit të studentëve. Vizita në laboratorin e imazherisë; Evidenca nr 86. Programi i studimit;

ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Evidenca nr 91. Plani mesimor; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve;
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim. Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Takimi me personelin akademik; Evidenca nr 86. Programi i studimit; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve;
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Referuar RVB, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. angazhimi i personelit akademik paralelisht në shërbimet spitalore, është avantazh mjaft i madh për studentët pasi sjellin eksperiencën e tyre me raste konkrete të cilat diskutohen dhe dhe interpretohen. Personeli akademik ushtron të drejtën e organizimit e mësimdhënies në përputhje me objektivat që ka programi i studimit. Për module të caktuara të kurrikulës, pas dhënies së informacionit teorik për grup kompetencash, studentët testohen t'i aplikojnë këto kompetenca në laboratorët ku zhvillohet praktika, jashtë FSHMT. Sikundër kemi theksuar, në institucion infrastruktura laboratorike e dedikuar për imazherinë është e zgjidhur nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës që QSUT disponon në imazherinë diagnostike. Takimi me studentët; Evidenca nr 122. Udhezues i praktikës profesionale; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 117. Lista e laboratoreve didaktike në te 3 Fakultetet – UMT; Evidenca nr 18. Konferenca vjetore FSHMT;

Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në FSHMT realizohen orë të hapura me studentë të interesuar për zhvillime të fundit në imazheri. GVJ konstaton se përgjithësisht personeli akademik ka bërë pjesë të lëndëve literaturë të përditësuar. Përsa i përket personelit të ftuar, apo me kontratë, vit pas viti ftohen pedagoge të ftuar nga universitetet dhe institucionet shëndetësore partnere në kuadër të projekteve apo konferencave të ndryshme që zhvillohen të cilët japin leksione me studentët për përmbajtjen e të cilave bihet dakord paraprakisht me departamentin. Synohet që përmbajtja e leksioneve jashtë programit të studimit të përfshijë të reja të fundit të shkencës dhe/ose teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e saj në mjekësi. Në varësi të fushës së veprimtarisë, personeli akademik organizon aktivitete ku përfshihen edhe studentë. Ndërkohë evente të ndryshme që zhvillohen në FSHMT, konferenca shkencore etj, studentët marrin pjesë në mënyrë interaktive. Evidenca www.ai4med.net, Evidenca nr 29. Programi i konferenca ne Universitetin e Vlorës; Evidenca nr 30. Konferenca vjetore 2023 FSHMT ne bashkepunim me UV dhe UISH;
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UMT ka të ngritur në nivel institucional Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e cila funksionon në bazë të statutit dhe rregullores. Institucioni ka miratuar me vendim të Senatit Akademik, Rregulloren e sigurimit të cilësisë ku përcaktohen mekanizmat e sigurimit të cilësisë. Prej pandemisë Covid 19, UMT dhe njësitë përbërëse përfshirë dhe FSHMT, kanë hartuar udhëzues përkatës për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UMT përdor metoda inovatore të mësimdhënies dhe të të nxëniet me në qendër studentin. Trajnimi i personelit akademik që jep mësim për herë të parë nga shefat e departamenteve, duke përcjellë praktikën më të mira dhe eksperiencat e tyre të akademikët e rinj. Evidenca nr 170.Plani strategjik;
Konkluzione	<i>Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka strukturë të posaçme në nivel institucional, që promovon rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. GVJ konstaton se personeli akademik ka bërë pjesë të</i>



	lëndëve, literaturë të përditësuar. Realizohen orë të hapura me studentë të interesuar për zhvillime të fundit në imazheri. Përsa i përket personelit të ftuar, apo me kontratë, vit pas viti fton pedagoge të ftuar nga universitetet dhe institucionet shëndetësore partnere në kuadër të projekteve apo konferencave të ndryshme që zhvillohen të cilët japin leksione me studentët për përmbajtjen e të cilave bihet dakord paraprakisht me departamentin			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e njësisë kryesore paraqet qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi. Sipas <i>nenit 50</i> të rregullores së FSHMT parashikohet diplomimi, ku sipas pikës 5 të këtij neni, studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës / të japë provimin përfundimtar, pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës. Në programin e studimit MSc Teknikë imazherie, realizohet me diplomë nëse studenti ka shlyer të gjitha detyrimet. Studenti ka në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e tij. Ndërkohë institucioni ka hartuar edhe një udhëzim për kriteret e zhvillimit të punës kërkimore dhe hartimit të diplomës. <i>GVJ nga shqyrtimi evidencave vëren që mungon në sistem Rregullorja e programit Msc Teknik imazherie. Rekomandohet që të plotësohet dokumentacioni.</i> Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT;
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli	Studentët asistohen si në aspektin e informimit të tyre lidhur me procesin e provimit final apo mbrojtjes së diplomës, ashtu

akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	edhe të përgatitjes për zhvillimin e provimit apo mbikëqyrjen e punimit të diplomës. Për studentët që i nënshtrohen provimit final, fakulteti dhe departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të testimit dhe vlerësimit. Në shërbim të studentëve vihen në dispozicion informacione, udhëzime, materialet e nevojshme në funksion të provimit final. Për çdo lëndë/modul të zhvilluar, departamentet mbledhin pyetje që lidhen me përmbajtjen e lëndës / modulit të zhvilluar. Më pas nga një fond i caktuar pyetjesh zgjidhen pyetjet për provimin final Evidenca nr 9. Udhëzues për hartimin e Temes së diplomës; Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve;
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar RVB, diplomimi në këtë program studimi realizohet nëpërmjet mbrojtjes së temës së diplomës. Përmbledhje e temave nga lëndët e zhvilluara, formate pyetjesh, u vihen në dispozicion studentëve ndërkohë bazuar në kërkesën e studentëve, departamenti organizon ore konsultimi për studentët që kanë vështirësi. Një Komision i posaçëm miratohet për mbrojtje të diplomës dhe vlerësimin e saj. Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Shlyerja e detyrimit përfundimtar në programin Master Shkencor, realizohet me mbrojtje diplome. Sikundër u theksua nga personeli akademik, departamenti përgatit një listë temash në të cilat studentët mund të orientohen dhe përzgjedhin temën dhe pedagogun respektiv. Gjatë gjithë kohës pedagogu është në kontakt të vazhdueshëm me studentin dhe udhëzon atë në çdo hap të procesit të realizimit të diplomës. Ai verifikon çdo informacion përgatitur, rezultat të nxjerrë dhe konfirmon atë para se studenti ta përfshijë në disertacionin e tij. Studenti ka detyrimin të dorëzojë 3 kopje të punimit një prej të cilave arkivohet në bibliotekën e fakultetit edhe në versionin elektronik. Evidenca nr 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve; Evidenca nr 9. Udhëzues i hartimit të diplomës;

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sikundër kemi përmendur edhe në vlerësimet e kritereve të tjera, GVJ e gjykon mjaft pozitive mundësinë që u jep studentëve akses në QSUT, pajisjet, databazën / arkivat mjekësore të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë fazës së zhvillimit të diplomës. Kjo u theksuar edhe nga studentët të cilët me fillimin e semestrit të dytë, fillojnë hartimin e diplomes Takimi me studentët;
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Siç përcaktohet në rregulloren e FSHMT, studentët pas përfundimit të provimit vlerësohen me notë ku nota 5 është kaluese dhe nota 10 vlerësimi maksimal. Në suplementin e diplomës shënohen dhe kreditet respektive të diplomës. GVJ konfirmon se komisioni i provimit është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit përfundimtar. Ndërkohë komisioni në përfundim prezanton para studentit rezultatin e vlerësimit të komisionit së bashku me komentet e më pas i bën ato publike brenda 2 orësh. Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Takimi me personelin akademik;
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rregulloren e përgjithshme përcaktohet qartë se studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, pajisen me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj, e cila është dokument zyrtar. Studenti pajiset me diplomën e programit të studimit Teknikë imazherie, suplementin e diplomës dhe kopje te programit të studimit të zhvilluar gjatë studimeve të tij. Evidenca nr 22 Suplementi diplome MSc teknik imazheri; Evidenca nr 86. Programi i studimit MSc. Teknike Imazherie; Evidenca nr 2. Rregullore UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHTM; Takimi me personelin administrativ;
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti	Sekretaria mësimore mban regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave apo certifikata të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas akteve nënligjore në fuqi.

informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në sekretarinë mësimore, u konstatua se sekretaria mësimore arkivon edhe dokumentacionin e plotë të studentëve të diplomuar sic janë listat e notave, dokumentacionin e aplikimit etj. Regjistrat e studentëve plotësohen në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahen në ruajtje të përhershme. Çdo student, me regjistrimin fillestar, pajiset me numër unik matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Vizita ne sekretarinë mësimore; Evidenca nr 2. Rregullore UMT;			
Konkluzione	<i>FSHMT ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Modalitetet e shlyerjes së detyrimeve të studenëve, diplomi, janë përcaktuar qartë rregullat për provimin e përgjithshëm përfundimtar. Rregullorja e universiteti, fakultetit përcakton gjithashtu procedurën që në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementar e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit.</i> <i>GVJ nga shqyrtimi evidencave vëren që institucioni mungon Rregullorja e programit Msc Teknik imazherie. Rekomandohet që të plotësohet dokumentacioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë	Nga vizitat në institucion, por edhe nga bisedat me personelin akademik dhe me studentë që frekuentojnë Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Teknikë imazherie", rezulton se FSHMT për realizimin e orëve

institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	laboratorike dhe praktikave lëndore ka vënë në dispozicion laboratorin e teknik imazherisë. Takimi me drejtuesit;			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Referuar RVB, FSHMT garanton kryerjen e praktikës profesionale me institucione shëndetsore publike, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar. Sikundër kemi theksuar, pjesa më e madhe e personelit akademik janë aktualisht pjesë e shërbimit shëndetësor e për rrjedhojë, nëpërmjet tyre sigurohet akses i studentëve në qendrat diagnossike brenda ose jashtë QSUT. Takimi me studentët e programit			
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nisur nga plani mësimor i programit të studimit të MSC në "teknik imazherie" praktika profesionale vlerësohet me kredite dhe zhvillohet bazuar në Manualin e praktikës profesionale . Praktika profesionale ka 12 kredite dhe zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Ecuria e studentit gjatë zhvillimit të praktikës profesionale ndiqet nga mbikëqyrësi klinik dhe nga pedagogu i i lëndës së praktikës Gjithashtu, edhe vlerësimi i studentit për praktikën profesionale bëhet përmes vlerësimit të pedagogut udhëheqës dhe mbikëqyrësit klinik, dhe vlerësimi përfundimtar me notë e bën komisioni në përfundim të praktikës Evidenca nr 6. Rregullore e DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 90. Plan mesimor MSH teknik imazherie;			
Konkluzione	<i>Rezultojnë se praktikat profesionale, për studentët që ndjekin Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Teknikë imazherie", realizohen kryesisht në QSUT. Nisur nga karkateri Shkencor që ka programi dhe mundësitë që ka institucioni me infrastrukturën e vënë në dispozicion nëpërmjet Qendrës spitalore Universitare, mendojmë se zhvillimi i saj është në një nga nivelet më të mira në nivel kombëtar edhe në shkollat pranë vendbanimit të studentëve. Praktika zhvillohet në përputhje me manualin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Msc në Teknik Imazherie, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2020- 2023 është si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2020 - 2022</th><th colspan="2">2021 - 2023</th><th colspan="2">2022 – 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE:</th><th>PAK:</th><th>PAE:</th><th>PAK:</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>1</td><td>4</td><td>1</td><td>4</td><td>1</td><td>4</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>7</td><td>3</td><td>7</td><td>3</td><td>7</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td></tr><tr><td>Në total</td><td>9</td><td>13</td><td>9</td><td>13</td><td>9</td><td>13</td></tr></table> Shënim: të dhënat janë dhënë për cikël të plotë studimi. Nga sa më sipër vihet re se 27 % e stafit mësimdhënës për këtë program studimi është më Msc, (PAK), në kundërshtim me pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015.	Tituj/grada	2020 - 2022		2021 - 2023		2022 – 2024		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	-	1	-	1	-	Prof.As.Dr	1	4	1	4	1	4	Dr/PhD	7	3	7	3	7	3	Msc	-	6	-	6	-	6	Në total	9	13	9	13	9	13
Tituj/grada	2020 - 2022		2021 - 2023		2022 – 2024																																												
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																											
Prof.Dr	1	-	1	-	1	-																																											
Prof.As.Dr	1	4	1	4	1	4																																											
Dr/PhD	7	3	7	3	7	3																																											
Msc	-	6	-	6	-	6																																											
Në total	9	13	9	13	9	13																																											

	<i>GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Msc në Teknik Imazherie, Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i> Evidenca nr 97. Statistika tabela; Evidenca nr 93, 94, 95. Programin MSC Teknik imazherie; Evidenca nr 96. CV-te e personelit akademik te angazhuar ne MSc. Teknik e imazherie;
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Stafi akademik me kohë të plotë që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje me fushën e programit të studimit, imazheri, diagnostikë dhe lëndë paraklinike. Angazhohen personel akademik me kontratë dhe të ftuar në bazë të nevojave që ka departamenti me lëndët të profilit teknik ose praktikat profesionale. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion edhe pse numri i PAE është më i madh, rreth 86% e ngarkesës mbulohet nga personeli i FSHMT & QSUT. Evidenca nr 91. Plani Mësimor; Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve MSc. Teknike Imazherie; Evidenca nr 96. CV-te e personelit akademik te angazhuar ne MSc. Teknik e imazherie;
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	FSHMT është fakulteti më i madh në vend në fushën e shkencave mjekësore teknike. Ky fakultet ka shërbyer prej vitesh si qendra në të cilën janë diplomuar dhe kualifikuar një pjesë e mire e stafëve mjekësore në fakultetet e tjera të vendit. Në këtë kontekst, punësimi në këtë fakultet synohet nga profesionistët e kësaj fushe. Në takimin me stafin akademik u evidentua se shumica prej tyre e kanë nisur karrierën e tyre në këtë fakultet dhe kanë avancuar në karrierën e tyre profesionale e shkencore. Mbështetja dhe klima pozitive reflektohet në qëndrueshmërinë afatgjatë të personelit akademik. Takim me perfaqësues të Zyres së burimeve njerëzore; Evidenca nr 97. Tabela përmbledhëse; Evidenca nr 96. CV-te e personelit akademik te angazhuar ne MSc. Teknik e imazherie;

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ evidentoi se institucioni ndjek procedurë të plotë vlerësimi të kandidatëve që aplikojnë për një pozicion të shpallur. Në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura gjithnjë është synuar përzgjedhja e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit por siç u përmend, për shkak të vështirësive, jo në çdo rast është arritur në rekrutimin e personelit të kategorisë profesor. <i>GVJ sugjeron institucionin të përfshijë në programin e studimit personel me tituj e grada shkencore, të gjejë rrugë dhe mekanizma alternativë për të bërë pjesë, staf akademik qoftë nga partnerët e bashkëpunorët apo edhe të ftuar në mënyrë që lëndët apo modulet e programit që lidhen me imazherinë dhe profesionin të mbulohen nga titullarë të së njëjtës fushë.</i> Nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore, administrohen të gjithë të dhënat mbi personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Dosjet e personelit përditësohen në mënyrë periodike. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. (Shembull dosje e personelit të arkivuar në zyrën e burimeve njerëzore). Evidenca nr 97. Tabela përmbledhëse, statistika personel; Evidenca nr 96. CV-te e personelit akademik të angazhuar në MSc. Teknik e imazherie; Evidenca nr 162. Procedurat e punësimit të personelit akademik, ndihmes., administrativ UMT;
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës	Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet Po ashtu për Programin e studimit Master i Shkencave në Teknik Imazheri përdoren kryesisht infrastruktura e spitaleve universitare për formimin praktik të studentëve. Gjatë këtyre orëve krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratore.



specifike të programit të studimit.	Angazhimi i stafit të imazherisë nga QSUT vlerësohet pozitiv nga GJV pasi janë teknikë imazherinë me eksperiencë që aktualisht punojnë dhe orientojnë studentët me informacione dhe eksperiencën e nevojshme klinike për një teknik imazherie. Personeli akademik dhe ndihmës akademik përgjegjës për programin e studimit, ka kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit në përputhje me Kodin dhe standardet e cilësisë. Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 97. Tabela, statistika ASCAL; Evidenca nr 90. Te dhena për zhvillimin e infrastruktures dhe investimet; Evidenca nr 118. Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë;
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	FSHMT siguron menaxhimin të burimeve njerëzore të institucionit. Për këtë qëllim zyra e Burimeve Njerëzore është një strukturë administrative koordinuese brenda institucionit e cila përditëson, menaxhon, ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e universitetit, Rregulloren e arkivimit të dokumentacionit. Zyra e burimeve njerëzore ndjek përmbushjen e detyrimeve kontraktore të punëmarrësve në përputhje edhe me kodin e etikës, mbledh dhe harton raporte statistikore për personelin sipas kërkesave të Institucionit apo institucioneve të tjera bashkëpunuese. Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 67. Shembull Pyetësor Vlerësim I studenteve për lëndet e programit të studimit; Shembull dosje personeli, zyra burimeve njerëzore; Evidenca nr 156. Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike;
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësojnë biznesin e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,	Sipas rregullores së programit, departamenti harton programin e praktikës profesionale sipas modelit përkatës si dhe cakton stafin akademik që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në objekt. Mbikëqyrja dhe ndjekja e këtyre seancave kryhet nga një pedagog, i caktuar nga departamenti, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës Stafi akademik përgjegjës në përfundim të praktikës profesionale, dorëzon në departament përmbledhje të dokumentacionit mbi kryerjen në institucione të ndryshme




udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe drejtohet nga pedagogu i caktuar nga departamenti. Institucioni ka një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me institucione të ndryshme shëndetësore që ofrojnë shërbimin e imazherisë. Roli i vetë personelit akademik është mjaft i rëndësishëm në bashkëpunimin me qendrat diagnostike pasi shumica prej tyre janë personel shëndetësor në këto klinika. Evidenca nr 48. Shembull marrëveshje bashkëpunimi me IAL nderkombetare; Evidenca nr 49. Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera; Evidenca nr 144. VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare; Evidenca nr 46. Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS;
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet. Mbikqyrja e praktikave profesionale realizohet nga personeli akademik i FSHMT ose ai i angazhuar me kohë të pjesshme. Përgjegjësi i departamentit siguron shpërndarjen e praktikës profesionale në shërbimin e QSUT apo institucionet e tjera duke angazhuar personelin që është pjesë e atij shërbimi. në mjediset spitalore. Studentët udhëzohen nga personeli i shërbimit, teknikë radiologë që janë të angazhuar si personnet akademik me kohë të pjesshme. Angazhimi i stafit ndihmës vlerësohet pozitiv pasi janë teknikë imazherinë me eksperiencë që aktualisht punojnë edhe në qendra diagnostike. Evidenca nr 13. Shembull ditar i praktikës profesionale; Evidenca nr 6. Rregullore e DDRSHIKIOGJ;
Konkluzione	<i>Personeli akademik efektiv dhe më kontratë që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Teknikë Imazherie, përmbush kryesisht kërkesat ligjore të kornizës rregullatore për IAL përsa i përket numrit dhe kualifikimit, fushës së veprimtarisë profesionale në përputhje me fushën e programit, lëndën apo praktikën profesionale që ata janë përgjegjës. Kjo sepse një pjesë e stafit janë me Master Shkencor. Pjesë e personelit akademik janë stafet mjekësore të QSUT çka ndihmon</i>

	<i>shumë në sjelljen e eskperincës klinike dhe transmetimin e saj tek studentët.</i> <i>Institucioni garanton qëndrueshmëri në rekrutimin e personelit akademik, si dhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</i> <i>GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Msc në Teknikë Imazherie, Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstatoi se UMT ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve në Power Point. Nga vizita në institucion u vërejt se mjediset mësimore janë të madhësive të ndryshme në përshtatje me natyrën e procesit mësimor që zhvillohet në to. Evidenca nr 90. Te dhena per zhvillimin e infrastruktures dhe investimet; Evidenca nr 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhënies, Universiteti i Mjekesise, Tirane; Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetore dhe analiza FSHMT;



	Evidenca nr 97. Statistika përmbledhëse;
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Bazuar në RVB dh enë dokumentacionin bashkëlidhur dhe të verifikuar gjatë vizitës në institucion, GVJ identifikoi se FSHMT disponon 2 godina: – Godina 1 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 6 auditorë me kapacitet 500 vende uljeje, 10 salla seminari me 50 vende uljeje, 4 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative; – Godina 2 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 11 auditorë me kapacitet 700 vende uljeje, 14 salla seminari me 50 vende uljeje, 3 laboratorë me 70 vende uljeje, si dhe 21 zyra administrative; Në periudhën 2020-2021 janë zhvilluar në total 7 laboratorë të rinj. Sallat laboratorike janë të bollshme dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillin normal të mësimit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Evidenca nr 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhënies, Universiteti i Mjekesise, Tirane; Evidenca nr 80-85. Raporte vjetore dhe analiza FSHMT dhe Departementi; Takimi me stafin administrativ FSHMT;
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vlerëson infrastrukturën laboratorike apo aksesin e siguar tek studentët e FSHMT mjaft pozitive pasi përveç infrastrukturës së brendshme studentët kanë akses edhe mjediset spitalore. Nga vizita në FSHMT dhe nga deklaratimet e personelit, rezultojnë një numër prej 72 laboratorë të dedikuar për veprimtaritë akademike në UMT, 30 laboratorë në Fakultetin e Mjekësisë, në Fakultetin e Mjekësisë Dentare 15 laboratorë, në FSHMT janë në përdorim 7 laboratorë infermierisë, laborator i imazherisë digjitale, laborator i anatomisë radiologjike, laborator i ekografisë. Për programin Teknik imazherie përveç laboratorëve të tjera, ekzistojnë e laboratorë specifikë për programin. Laboratori i anatomisë radiologjike, dhe Laboratori i imazherisë digjitale. Shumica e tyre janë investim i drejtpërdrejtë i institucionit dhe partnerëve (projekti HAP ka ndërtuar 2 laboratorë).

	Evidenca nr 117. Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet – UMT; Evidenca nr 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane; Takimi me stafin administrativ FSHMT;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Aksesi në kompjutera dhe internet mundësohet në dy mjedise të dedikuara në FSHMT. Laboratori i imazherisë digjitale është i pajisur nga 22 pc me karakteristika mjaft të mira për të vizualizuar dhe përpunuar imazhe mjekësore dhe akses në internet si dhe në bibliotekën e fakultetit. Studentët mund të aksesojnë edhe mjedise të tjera në universitet përfshirë dhe ambientet e telemjekësisë. Bazuar në të dhënat e deklaruara në UMT janë në përdorim për studentët 8 salla informatike. Evidenca nr 117. Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet – UMT; Evidenca nr 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane;
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	GVJ konstaton se një nga pikat më të forta të FSHMT dhe institucionit në tërësi është roli që ka në formimin e profesionistëve të fushës së mjekësisë. Gjatë takimeve u theksua roli që ka patur UMT në përballimin e pandemisë Covid 19 ku pothuaj i gjithë stafi i UMT ka patur një rol në një nga strukturat spitalore ose të shërbimit. Kjo e bën UMT të përfshirë në mjaft politika dhe të ketë rol drejtues në realizimin e strategjive në fushën e shëndetësisë. UMT drejton dhe koordinon veprimtari në fushën e shëndetësisë, kërkimit, projekteve etj. Në këtë mënyrë, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet; marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Ne e vërtetojmë se ka një bashkëpunim të gjerë me institucionet e tjera në arsim dhe shëndetësi. Edhe brenda FSHMT u evidentua një marrëdhënie konstruktive bashkëpunimi ku në rastin konkret edhe pse programi administrohet nga departamenti DDRSHIKIOGJ, të gjitha strukturat kontribuojnë në zhvillimin me sukses të programit të studimit. Takimi me drejtuesit, Takimi me stafin akademik;

	Evidenca 144.VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare;			
Konkluzione	<i>GVJ gjatë vizitës në institucion vëren që FSHMT ka infrastrukturën e duhur në salla leksionesh, seminaresh, laboratorë profesionalë, si laborator i anatomisë radiologjike, dhe laborator i imazherisë digjitale. Infrastruktura në dispozicion të studentëve të MSc në Teknikë imazherie bën të mundur realizimin e programit të studimit dhe marrjen e aftësive teorike dhe praktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni u siguron studentëve të programit të studimit MSc në Teknikë Imazherie, materiale përmbledhëse si dhe literaturën e rekomanduar në gjuhën shqipe Megjithatë <i>GVJ</i> konstaton se botimet në shqip në fushën e imazherisë janë të limituara dhe sipas deklarimeve të stafit, janë duke hartuar përmbledhje dhe përshtatje të literaturës. Materialet e përgatitura u jepen studentëve në mënyrë fizike ose elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të UMT, google-clasroom . <i>GVJ</i> sygjeron departamentin të mbështesë personelin të hartojë dhe botojë tekste të viteve të fundit për imazherinë që sikundër janë botuar edhe tekste për programet e tjera. Literatura gjendet në formë elektronike në bibliotekën e institucionit dhe libraritë elektronike Sage&Ebsco, Questia, COBISS. Evidenca nr 23. Shembull_nderfaqe Googleclassroom; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden); Evidenca nr 113. Biblioteka FSHMT;

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Evidenca nr 114. Bibliotekat online , lista dhe përshkrim; Bazuar në deklaratimet e personelit akademik, çdo fillim viti kërkohet nga personeli të përditësohen syllabuset e lëndëve me literaturë bazë dhe ndihmëse. Literatura e përdorur bazohet në botime të autorëve të njohur e botuar brenda 5 viteve të fundit. <i>Megjithatë, sikundër kemi theksuar, ka raste ku literatura në syllabuse është më shumë se 5 vite. <u>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës pasi për disa lëndë raportohet një literature e pa përditësuar.</u></i> Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve MSc. Teknike Imazherie; Evidenca nr 11. Praktike per miratimit e planeve mesimore;
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në UMT funksionojnë disa biblioteka, biblioteka qendrore dhe bibliotekat e fakulteteve. Biblioteka qendrore ka gjendje rreth 53,000 libra dhe revista shkencore të mjekësisë në gjuhë shqipe dhe të huaj. Biblioteka e fakultetit arkivon dhe mirëmban arkivin e saj dhe e vendos atë në dispozicion të stafit dhe studentëve. GVJ konstatoi mjedis të bollshëm për lexim nga studentët si dhe akses në internet në libraritë online. Evidenca nr 113. Biblioteka FSHMT; Evidenca nr 181. Rregullore mbi botimet mesimore-shkencore ne UMT; Evidenca nr 10. Revista shkencore e FSHMT 2022-23; Evidenca nr 172. Rregullore e funksionimit te Këshillit te Etikës – UMT;
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	Në UMT funksionojnë disa biblioteka, biblioteka qendrore dhe bibliotekat e fakulteteve. Biblioteka qendrore ka gjendje rreth 53,000 libra dhe revista shkencore të mjekësisë në gjuhë shqipe dhe të huaj. Biblioteka e fakultetit arkivon dhe mirëmban arkivin e saj dhe e vendos atë në dispozicion të stafit dhe studentëve. GVJ konstatoi mjedis të bollshëm për lexim nga studentët si dhe akses në internet në libraritë online. Evidenca nr 113. Biblioteka FSHMT; Evidenca nr 181. Rregullore mbi botimet mesimore-shkencore ne UMT;

specifikës së programit të studimit.	Evidenca nr 10. Revista shkencore e FSHMT 2022-23; Evidenca nr 172. Rregullore e funksionimit të Këshillit të Etikës – UMT;
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UMT dhe fakulteti kanë siguruar disa aksesë në libraritë online pa pagesë për studentët të cilët mund të gjejnë dhe aksesojnë literaturën e dëshiruar: Hinari, Telemedicine, Albanian Health foundation, etj. Ndërkohë, në laboratorin e imazherisë dixhitale është krijuar një databazë botimesh të viteve të fundit e cila është e aksesueshme nga studentët. Vizita në bibliotekë; Vizita në laboratorin e imazherisë digjitale;
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me tekste mësimore, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja të revistave shkencore. Literatura fizike në bibliotekë, pasurohet çdo vit. Stafi akademik parashton kërkesën për blerjen e literaturës. Në bibliotekë mundësohet akses në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia. Materialeve të vëna në dispozicion të studentëve nga titullarët nëpërmjet sistemit janë kryesisht përmblendhje të literaturës. Literatura në gjuhën angleze është mjaft cilësore dhe institucioni ka siguruar akses dhe të drejta në përdorimin e saj, vë vijim stafi duhet të fokusohet në përgatitjen e botimeve të plota në shqip në mënyrë që studentët të kenë materiale të mjaftueshme për tu thelluar në studimet e tyre. Evidenca nr 146. Sherbimet e Telemjekesise; Evidenca nr 24. Udhezues biblioteka online; Evidenca nr 113. Biblioteka FSHMT;
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHMT funksionon dhe organizohet sipas rregullores së brendshme të saj. Ambienti i bibliotekës dhe sallës së leximit është vendosur në katin e pestë dhe ku mundësohet edhe akses në internet dhe është e hapur nga ora 8.00 deri në orën 18.00. Sipas deklarimeve, ambienti i bibliotekës shërben edhe si mjedis takimi për studentët organizojnë etj Evidenca nr 113. Biblioteka FSHMT;

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në deklaratimet e punonjësve të bibliotekës, u theksua se në vitet e fundit fakulteti është orientuar në investimet për pasurimin digjital të bibliotekës. Bazuar në kërkesat individuale të pedagogëve dhe studentëve i drejtohet administratorit të fakultetit për vënie në dispozicion të botimeve të reja ose sigurim aksesi në libraritë online nëpërmjet abonimeve të ndryshme. GVJ vlerëson pozitivisht aksesin në literaturën elektronike kryesisht të huaj të sigurua nga ana e institucionit. Megjithatë, pasurimi i mëtijshëm i fondit fizik të bibliotekës është i nevojshëm. GVJ evidentoi si praktikë të mirë të bibliotekës, arkivimin e punimeve shkencore të stafit dhe studentëve, diplomave etj duke i vënë ato në përdorim për të interesuarit. Evidenca nr 24. Udhëzues biblioteka online; Evidenca nr 113. Biblioteka FSHMT; Evidenca nr 80-81-82. Raporte FSHMT; Evidenca nr 84-85. Analiza departamenti; Evidenca nr 114. Bibliotekat online;			
Konkluzione	<i>UMT dhe fakulteti kanë siguruar disa aksese në libraritë online pa pagesë për studentët të cilët mund të gjejnë dhe aksesojnë literaturën e dëshiruar: Hinari, Telemedicine, Albanian Health foundation, etj. Ndërkohë, në laboratorin e imazherisë dixhitale është krijuar një databazë botimesh të viteve të fundit e cila është e aksesueshme nga studentët.</i> <i>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës pasi për disa lëndë raportohet një literature e pa përditësuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Përfaqësuesit e institucionit deklarojnë se gjatë pandemisë COVID 19, institucioni ka bërë hapa pozitivë në përmirësimin e infrastrukturës digjitale dhe përdorimin e simeve të menaxhimit UMT Easy-Ëeb është sistemi i institucionit për në administrimin e aktivitetit akademik, mësimor dhe edukimin në vazhdim. GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet për zhvillimin e sistemeve dhe përdorimin e tyre nga stafi i institucionit jo vetëm si mjet i shpejtë komunikimi por edhe për rritjen e transparencës në vlerësime, testime etj. P.sh përdorimi i sistemit Clean Score në bashkëpunim me AADF. Evidenca nr 116. Projekti i Qendres se Biosimulimit klinik dhe Edukimit ne vazhdim UMT; Evidenca nr 74. Shembul Vendim Rektorati Per implementimin e platformes online EasyWeb LMS ne UMT; Evidenca nr 148. Pershkrim funksionaliteve te platformes EasyWeb LMS;
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UMT ka në përdorim disa sisteme ose platforma si p.sh sistemi i menaxhimit, renditjes se maturantëve (I cili përdoret për renditjen e maturantëve në ciklin e parë ose në programet e integruara), sistemin e sekretarisë mësimore Pitagora, sistemin e korigjimit të provimeve, Google education, Sistemi i regjistrimit të të diplomuarve pas përfundimit të studimit “Gradua” me koordinator kryesor Universiteti Bujqësor i Tiranës. etj Evidenca nr 43. Nderfaqe sistem elektronik i dedikuar per pikezimin dhe renditjen e aplikanteve; Evidenca nr 40. Nderfaqe sistemi Pitagora; Evidenca nr 41. Nderfaqe UMED google education; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden);
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Përveç aksesit në shërbime të ndryshme, sistemet që UMT, FSHMT përdor sigurojnë akses në informacione të tjera si libraritë online, e-maile, hapësirë për stafin etj. Sistemi ofron informacionin bazë për studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin çdo pedagog menaxhon krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse, UMT easy -ëeb është platforma kryesore për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi

	detyrave te kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden); Evidenca nr 150. Permbledhje Manuale EasyWeb;
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Ssitemi UMT jep akses për të gjithë studentët dhe personelin akademik dhe profesionistët e shëndetësi. Në UMT përdoret Google education me akse në E-mailët e institucionit, hapësirë të dedikuar në Google Drive pa limit, akses në libraritë online dhe arkivin elektronik që institucioni disponon, email me domain @umed.edu.al] etj. UMT ka në përdorim të gjitha ndryshme që disponon, si libraritë online, "E-Research", "Training4ALL", "Virtual university", "U-Library" Për të promovuar aktivitetin akademik dhe social, UMT përdor gjërësisht rrjetet sociale, facebook, instagram, grupe në platforma ehatsapp dhe viber etj, mjaft të përdorura nga studentët. Ndërkohë, përveç faqes zyrtare që shërben për të dhënë informacion të plotë rreth procedurave të pranimit dhe regjistrimit në institucion, kostove të edukimit, organizimit dhe menaxhimit të institucionit. Evidenca nr 142. Print screen të shërbimeve të RASH; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden); Evidenca nr 150. Permbledhje Manuale EasyWeb; Evidenca nr 12. Nderfaqe Facebook FSHMT;
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemet që UMT përdor mundësojnë marrjen ose gjenerimin e disa informacioneve në kohë reale për procese që institucioni zhvillon. Ecuria akademike, zhvillimi i procesit mësimor, rezultatet e studentëve dhe veprimtari të tjera që lidhen me procesin mësimor, janë lehtësisht të monitorueshme nëpërmjet UMT-LMS ku përgjegjës është NJSBC. Evidenca nr 23. shembull Google classroom; Evidenca nr 142. Print screen të shërbimeve të RASH; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden);
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	FSHMT zotëron një faqe web aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep infomacioneve të ndryshme. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të UMT-së që është aktive në dy gjuhë, dhe përditësohet periodikisht me aktivitetin e fakultetit, departamenteve. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit. Evidenca nr 12. Nderfaqe Facebook FSHMT; Evidenca nr 168. Nderfaqja e internetit FSHMT;			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson implementimin e disa sistemeve të brendshëm për menaxhim institucional, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet për zhvillimin e sistemeve dhe përdorimin e tyre nga stafi i institucionit jo vetëm si mjet i shpejtë komunikimi por edhe për rritjen e transparencës në vlerësime, testime etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar RVB, UMT, zhvillon analizën vjetore në të cilën analizohet e gjithë veprimtaria e institucionit Raporti bën transparent aktivitetet e brendshme dhe të jashtme të institucionit, shpenzimet, të ardhurat infrastrukturën dhe të dhëna për programet e studimit dhe numrin e studenteve përkatës. Raporti është përmbledhës i veprimtarisë akademike, financiare e shkencore i UMT dhe dërgohet zyrtarisht në MAS. Evidenca nr 79. Raporte vjetore UMT; Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetore FSHMT; Evidenca nr 154. Analize për aktivitetin -shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT; Evidenca nr 83.84, 85. Analize departamenti;

Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grandet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Sikundër përmendëm, plani i financimit është pjesë integrale e menaxhimit financiar të institucionit. Nevojat për programin e studimit kërkohen nga përgjegjësi i departamentit duke filluar nga nevoja për personel akademik, infrastrukturë laboratorike, logjistikë, literaturë, mbulim shpenzimesh për zhvillim veprimtarish akademike apo pjesëmarrje në to brenda dhe jashtë vendit etj. Financimi i burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, janë pjesë e financimit tërësor të programeve të FSHMT. Menaxhimi bëhet në përputhje me bazën ligjore të arsimit të lartë. Në planet e financimit jepen informacione mbi kostot për programet e studimit në tërësi por jo për çdo program në veçanti. Evidenca nr 166. Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore; Evidenca nr 167. Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 52. Praktike për miratimin e buxhetit vjetor UMT;
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Veprimtaria financiare e UMT është objekt i auditeve ligjore të pasqyrave financiare, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe kërkesave ndërkombëtare të auditimit të raportimit financiar. Prej miratimit të Statutit të ri sipas Ligjit 80/15, i gjithë procesi financiar dhe administrimi bëhet bazuar në këtë bazë ligjore përveç atyre të cituara më lart. Të gjitha të dhënat, analizohen nga organet drejtuese të UMT, Bordi i Administrimit dhe Senati akademik, evidentohen problematikat në politikat e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të procesit akademik. FSHMT kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij nëpërmjet Njësive të Auditit të Brendshëm, dhe gjithashtu, përdor dhe instrumente të tjerë të jashtëm (audit i jashtëm) për procesin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit, për përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm. Evidenca nr 79. Raporti Vjetor_UMT_2020-2021;

	Evidenca nr 79.1.Raporti Vjetor_UMT_ 2021-2022; Evidenca nr 80.Raport vjetor FSHMT 2020-2021; Evidenca nr 81.Raport vjetor FSHMT 2021-2022; Evidenca nr 82.Raporti vjetor FSHMT 2023; Evidenca nr 50. Praktika e ndjekur per auditim nga njesi audituese e jashtme (UNICEF); Evidenca nr 51. Praktika e ndjekur per auditim nga Njesia e Auditit te Brendshem;
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se monitorimi i ecurisë së veprimtarive akademike të UMT/FSHMT, kontrolli, auditimi dhe raportimi është i vazhdueshëm nëpërmjet raportit vjetor, i cili hartohet në zbatim të LAL 80/2015. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Evidenca nr 3. Rregullore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; Evidenca nr 79. Raporte vjetore UMT; Evidenca nr 80-82-83. Raport FSHMT; Evidenca nr 110. Analize vjetore zyra e finances; Evidenca nr 177. Rregullore për administrimin financiar kontabilitetin dhe kontrollin në- MT;
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Burimet financiare të institucionit janë hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të UMT, duke ndjekur një politikë transparente të shpërndarjes së tyre. UMT/FSHMT garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Institucioni ka të drejtën e përdorimit të të ardhurave të veta dhe i trashëgon në masën 100% në veprimtari apo shërbime që zhvillon UMT. Evidenca nr 52. Praktike per miratimin e buxhetit vjetor UMT; Evidenca nr 53. Procedura per miratimin e buxhetit vjetor; Evidenca nr 54. Procedura e hartimit te projekt buxhetit afatmesëm; Evidenca nr 79. Raporte vjetore UMT;

Konkluzione	<i>UMT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, nga tarifa e studentëve dhe të ardhura të buxhetit të shtetit. Rezultatet e studentëve janë të larta duke siguruar në këtë mënyrë një numër të lartë bursash dhe mbështetje për studentët</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë.	Bazuar në LAL 80/2015, statutin dhe rregulloren e UMT, si çdo IAL në vend, është i pavarur për përcaktimin e kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit. GVJ vlerëson kriterin e mesatares prej 7.5 për përzgjedhjen që aplikon institucioni dhe identifikon se nëpërmjet aplikimit të tyre, arrihet përzgjedhja e studentëve me rezultatet më të larta në shkallë vendi në fushën e imazherisë. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në Guidën e FSHMT. Institucioni ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë studimeve të tij. Dokumenton dhe ve në dispozicion të tij, informacione që lidhen me ecurinë e tij akademike. Në regjistrimin e studentëve në UMT ndiqen Vendime të Këshillit të Ministrave apo udhëzime të MAS për procedurat e përzgjedhjes, regjistrimit transferimit etj.

	Evidenca nr 136. Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar; Evidenca nr 6. Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarise mesimore;
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Pranimi i kandidatëve bëhet në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara dhe të pranuar. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj. Rregullorja e FSHMT, përmban procedurat e ndjekjes së studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre. Evidenca nr 136. Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar; Evidenca nr 137. Praktike per miratimin kuotave cikli i pare dhe integruar;
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret e pranimit dhe përparimit të studimeve të studentëve, janë publike dhe miratohen 1 vit në avancë. Transferimi nga një program studimi tjetër, njohja së studimeve të kryera në një program tjetër i plotë ose i pjesshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus apo programe të tjera shkëmbimi studimesh përcaktohen qartë në rregulloren e fakultetit. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun përmes faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale të UMT. Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarise mesimore; Evidenca nr 136. Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar; Evidenca nr 139. Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave te pranimit ne programet ciklit te pare PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT; Evidenca nr 138. Raporti MAS per verifikimin e kapaciteteve pritese per pranimet certifikimi i kuotave, www.umed.edu.al;
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme,	Kriteret e pranimit dhe ecures së studentëve, janë publike dhe miratohen në avancë. Transferimi nga një program studimi tjetër, njohja së studimeve të kryera në një program tjetër i plotë ose i pjesshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus apo programe të tjera shkëmbimi studimesh përcaktohen qartë në rregulloren e fakultetit. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun përmes faqes

të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	zyrtare dhe rrjeteve sociale të Universitetit. Transferimi i studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UMT dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Evidenca nr 139. Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave te pranimi ne programet ciklit te pare PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT; Evidenca nr 138. Raporti MAS per verifikimin e kapaciteteve pritesë per pranimet certifikimi i kuotave, www.umed.edu.al; Evidenca nr 2. Rregullore e Universiteti te Mjekesise, Tiranë; Evidenca nr 5 Rregullore FSHMT;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Institucioni prej vitesh merr pjesë në Panaiet Work & Study të organizuar në rrethe dhe në Tiranë, me përfaqësues nga zyra e Informimit dhe Njësitë akademike. Informacion të bollshëm ka dhe në katalogun e universitetit, faqe zyrtare e UMT, rrjete të komunikimit social si profili në Facebook/Meta, Instagram, si dhe materiale informuese si broshura, fletëpalosje duke informuar studentët kandidatë rreth programeve qe ofron. Evidenca nr 123. Shembull Broshure Informuese per studentet FSHMT; Evidenca nr 131. Nderfaqe Publikimi i listës së aplikuesve dhe fituesve për program studimi; Evidenca nr 143.Nderfaqe ëeb UMT;
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në pranimin dhe regjistrimin e studentëve, përveç kriterëve të institucionit, ndiqen Vendime të Këshillit të Ministrave apo udhëzime të MAS për kufizime në përmbushje të kërkesave të pranimi apo në kuota regjistrimi. Pranimi i kandidatëve bëhet në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara dhe të pranuar. Janë parashikuar edhe studentë të huaj për të ndjekur programin por ende nuk ka të regjistruar nga jashtë vendit. Evidenca nr 139. Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave te pranimi ne programet ciklit te pare PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT; Evidenca nr 123. Shembull Broshure Informuese per studentet FSHMT;



	Evidenca nr 143. Nderfaqe web UMT, Nderfaqe Facebook, FSHMT;			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UMT realizon komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programit përmes disa mënyrave si gjimnaz tour, këshillimi në UMT dhe FSHMT gjatë periudhës së regjistrimeve, etj. Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet java e orientimit ku realizohen takime leksione, për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UMT. Kriteret e programeve të studimit publikohen dhe i vihen në dispozicion palëve të interesuar nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme. UMT publikon kuotat për kategoritë e studentëve nga trojet përpara çdo viti akademik bazuar në historikun e kërkesave gjatë viteve paraardhëse. Kandidatët nga trojet të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM. Evidenca nr 137. Praktike per miratimine kuotave cikli i pare dhe integruar; Evidenca nr 138. Raporti MAS per verifikimin e kapaciteteve pritesë per pranimet certifikimi i kuotave;			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Për shtresat në nevojë UMT, ofron lehtësira financiare (bursa studimi), të cilat parashikohen në kontratat individuale të cilat rimbursohen nga buxheti i shtetit për llogari të UMT, pas depozitimit të kërkesës në departamentin përkatës. Studentët e interesuar për fitimin e mbështetjes financiare duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm në zyrat e protokollit të cilat me shkresë shoqëruese të Dekanit të Fakultetit shoqërohet për depozitim dhe shqyrtim në Bordin e Administrimit. Evidenca nr 137. Praktike per miratimine kuotave cikli i pare dhe integruar; Evidenca nr 89. Te dhena per bursat e studenteve FSHMT;			
Konkluzione	<i>UMT ka hartuar, ndjek e zbaton politika dhe procedura për pranimin e studentëve, përzgjedhjen e tyre, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MSC në Teknik imazherie</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstatoi se studentët informoheshin nga zyra e karrierës, përgjegjësi i programit të studimit dhe tutori i vitit përkatës në lidhje me rregulloret e shkollës, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj. Këto zyra i krijojnë mundësi studentit të kontrollojë vlerësimin por edhe të marrë shërbime të tjera si: regjistrimin në një provimi, listën e notave, vërtetime etj. Informacioni zyrtar në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin përfshihen në sistemin e menaxhimit të universitetit. Evidenca nr 91. Syllabuset e lendeve; Evidenca nr 130. Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studenteve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit;
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Rregullorja e Fakultetit, si dhe zyra e sekretarisë mësimore, ofrojnë informacion dhe udhëzime të hollësishme për studentët mbi procedurat, në bazë të kushteve të njohjes dhe transferimit të krediteve. Në Rregulloren e Departamentit <i>nenet 46; 47, 48</i> , citohen njohja dhe Ekuivalentimi i studimeve, diplomave dhe kalimin nga një program studimi në një tjetër. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik. Evidenca nr 3. Rregullore UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarisë mesimore; Evidenca nr 98. Tabela me statistikën e studenteve MSc. Teknike imazherie (regjistrim, transferim, diplomë); Evidenca nr 6. Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ;
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Aktet rregullatore të institucionit, si Rregullore e UMT, rregullore FSHMT, kanë informacion mbi kriteret dhe

me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit. Sipas <i>nenit 88</i> të rregullores së UMT, parashikohen format e kontrollit të dijeve. Kontrolli i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor. Evidenca nr 2.Rregullore UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidenca nr 6. Rregullore Departamenti;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në dokumentat rregullatorë përshkruhen mënyrat për mbrojtjen e diplomës. Sipas <i>pikës 3 nenit 50</i> të rregullores së UMT, studimet në ciklin e dytë Master i Shkencave, përmbyllen me punim / temë diplome, dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave”, në fushën e arsimit të kryer. Në këtë program studimi është parashikuar mbrojtje diplome me temë për diplomimin e studentëve. Procesi i diplomimit realizohet me anë të mbrojtjes së mikrotezës. Gjithashtu ka dhe një udhëzues për strukturën e temës së diplomës. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Departamenti, si strukturë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit me qëllim që t’u krijojë atyre kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të programit. Evidenca nr 2.Rregullore UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT; Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidenca nr 6. Rregullore Departamenti; Evidenca nr 9.Udhëzues për hartimin e temës së diplomes;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të	Sipas planit të veprimit të zyrës së mbështetjes ndaj studentëve, synimi i informimit është t’i ofrojë studentëve objektiva dhe të dhëna faktike për UMT dhe programin e studimit në veçanti. Procesi iniciohet aktualisht nga MAS (në vitet e mëparshme ka qenë iniciativë e vetë institucionit) ku përcaktohen:

posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	– periudha e informimit; – përfaqësuesit IAL-së; – Bashkëpunimi me institucionet e arsimit para universitar me qëllim përputhjen e periudhës së vizitës; UMT organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë FSHMT nga afër e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi, si edhe javën e orientimit për studentët e rinj. Guida e studentëve, e cila shpërndahet gjatë ditëve të orientimit të apo të takimeve që kryhen në UMT me fokus grupet e interesuara. Në përgjithësi numri i programeve të imazherisë janë të pakta në shkallë vendi. Kryesisht studentët që regjistrohen vijnë nga program bachelor i vetë institucioni ose nga 1 institucion publik dhe dy institucione private që ofrojnë program të ngjashëm. Evidenca nr 128. Orientimi dhe informimii maturanteve FSHMT; Evidenca nr 92.Syllabuset e lendeve MSc. Teknike Imazherie;			
Konkluzione	Universiteti ka vendosur në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve. Informacion i plotë jepet edhe në rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe	Java e orientimit të studentëve konsiston në prezantimin e tyre me ambientet e institucionit (sallat e mësimi, sekretarinë, bibliotekën, sallën e informatikës, etj.). Gjithashtu prezantohen pedagogët dhe lëndët që do të zhvillojnë, me syllabuset e secilit modul/lende. Studentët sqarohen lidhur me sezonet e provimeve, mënyrën e vlerësimit, të drejtat dhe detyrat e tyre.

kohëzgjatjen e programit të studimit.	Ata pajisen secili me informacionet e duhura, broshura etj. Informacion më i detajuar mbi sezonet e provimeve, mënyrën e vlerësimit i jepet studentit në javën e parë të vitit akademik nga titullari i secilës lëndë. Po ashtu ky informacion gjendet edhe në faqen zyrtare të UMT. Evidenca nr 92. Syllabuset e lendeve MSc. Teknike Imazherie; Evidenca nr 128. Orientimi dhe informimi i maturanteve FSHMT;
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Informacioni kryesor jepet në përmbajtje të programit të studimit. Departamenti vë në dispozicion të studentëve të përmbajtjen dhe informacione shtesë për dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu, informacione gjenden edhe në faqen e internetit të UMT dhe FSHMT. Nga personeli vihen në dispozicion informacion rreth përmbajtjes së moduleve si, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës http://fshmt.edu.al.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës nëpërmjet funksionimit të Zyrës së karrierës, duke ju ardhur në ndihmë të gjithë studentëve që vazhdojnë dhe që kanë përfunduar studimet në UMT/FSHMT, për të arritur potencialin e tyre maksimal dhe për tu mirëorientuar në tregun e punës. Ditët e Informimit përfshijnë edhe aktivitete të tjera si realizimin e takimeve midis klinikave të ndryshme, agjencive të punësimit të punësimit jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë. Informimi i studentëve në raport me vendet vakante për profesionet e tyre jashtë vendit dhe kriteret që ato kanë, këto kompani mund ti paraqesin edhe në mjediset në institucion. Studentët deklarojnë se ata kanë siguruar kontakte dhe informacione gjatë fazës së zhvillimit të praktikave profesionale. Evidenca nr 107. Manuali i karrieres se studenteve FSHMT; Evidenca nr 108. Aktivitete te zyres se karrieres FSHMT;
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për	Sikundër kemi përmendur më lart, studentët kanë akses në platformën UMT Easy web, Pitagora, emaileve, nga ku mund të informohet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,


zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Tutori i programit ka kontakt të përhershëm me studentët dhe i asiston ata në nevojën që mund të kenë për informacione të ndryshme. Një përshkrim i ambienteve dhe logjistikës ofrohet në fillim të programit. Gjatë vizitave të tyre në ambientet e universitetit studentëve u jepet një informacion i thelluar në lidhje me zyrat dhe shërbimet e ndryshme që ofrojnë në shërbim të studentit. Studentë marrin pjesë edhe në javën e bluzave të bardha të organizuar nga institucioni. Evidenca nr 128. Orientimi dhe informimii maturanteve FSHMT; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden); Evidenca nr 74. Shembul Vendim Rektorati Per implementimin e platformes online EasyWeb LMS ne UMT; Evidenca nr 148. Pershkrim funksionaliteve te platformes EasyWeb LMS;			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentëve, u sigurohet llogari personale për të pasur akses në listën e tyre të notave, mungesat e tyre si dhe situatën e tyre financiare. Kjo gjë bëhet e mundur online në sistemin e menaxhimit (Pitagora). Studenti mund të ketë akses në platformën Pitagora nga çdo ambient ku mund të ndodhet. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm që UMT disponon Evidenca nr 149. Pershkrimi i funksionaliteve te sistemit PITAGORA; Evidenca nr 150. Permbledhje Manuale EasyWeb;			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se sistemi i informimit të studentëve funksionon pasi vetë studentët deklarojnë se janë të informuar dhe mbështeten nga institucioni. Institucioni ka informacione mbi tregun e punës dhe studentët orientohen nëpërmjet zyrës së karrierës. Aplikimi i një sistemi të informatizuar konsiderohet praktikë e mirë nga ana e GVJ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe zyrës së mbështetjes ndaj studenteve, Zyrës së karrierës, fakultetit disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Teknikë Imazherie, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomon, si dhe të dhëna që kanë të bëjnë me numrin e studentëve që vazhdojnë studimet aktualisht në programin e studimit, numrin e të diplomuarve etj. Këto të dhëna mblidhen dhe analizohen nga Zyra e Karrierës dhe Alumni dhe Sekretaria Mësimore, Drejtoria e kurrikulave në nivel universiteti. Evidenca nr 97. Tabelat përmbledhëse; Evidenca nr 98. Tabela me statistikat e studenteve MSc. Teknike imazherie; Evidenca nr 128. Orientimi dhe informimii maturanteve FSHMT; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden);
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në regjistrin elektronik dhe hard copy që mban sekretaria mësimore pasqyrohet ecuria akademike vjetore e studentëve, duke përfshirë vlerësimin, frekuentimin etj. Për çdo student mbahen rekordet në lidhje me tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, ndërprerja e përkohshme. Në versionin elektronik, sistemi i menaxhimit lejon hedhjen e të dhënave personale të studentëve, të dhënave të tyre akademike e financiare. Pasurimi i sistemit të menaxhimit më të dhëna të ndryshme bën të mundur që prej tij të gjenerohen të dhëna që shërbejnë për raportime të ndryshme. Mbështetur në vizitën në institucion, rezultoi se numri i studentëve të regjistruar në katër vite akademike për këtë program studimi është: Viti akademik 2020 – 2021 12 studentë; Viti akademik 2021 – 2022 24 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 30 studentë; Viti akademik 2023 – 2024 34 studentë;

	Evidenca nr 97. Tabelat përmbledhëse; Evidenca nr 128. Orientimi dhe informimii maturanteve FSHMT; Evidenca nr 42. Nderfaqe EasyWeb (per lenden);
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	UMT disponon të dhëna për ecurinë e studentëve. Në sekretarinë mësimore, çdo student ka dosjen e tij me të dhëna nga regjistrimi deri tek diplomimi. Pas diplomimit, institucioni ruan kopje të dokumenteve për një kohë të pacaktuar si diploma, notat. ruajtja e cilave është detyrim ligjor që dokumentacioni të ruhet në të dy formate. Kopja në letër gjithmonë arkivohet dhe elektronikisht në formatin origjinal të prodhimit të saj. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga stafi akademik, sekretaria mësimore dhe vetë studenti në llogarinë e tij. Evidenca nr 2. Rregulore e UMT; Evidenca nr 150. Përmbledhje Manuale EasyWeb;
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Përpunimi i të dhënave personale të studentëve kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e institucionit. Informacionet administrohen nga UMT nëpërmjet Zyrës së IT ku një person përgjegjës ka rol kryesor në menaxhimin teknik të sistemit. Gjithashtu UMT ka njësi nëpërmjet procesit të mbikëqyrjes dhe vlerësimit garantojnë autonominë e institucionit si p.sh Njësia e Adutit të brendshëm e cila siguron zbatimin e kërkesave ligjore, politikave. Sipas planit vjetor të punës njësia ushtron kontrolle për auditimin e veprimtarisë së institucionit. GVJ gjykon se veprimtaria në kuadër kontrollin periodik të përvitshëm për menaxhimin e veprimtarisë dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse kryhet në përputhje me aktet e brendshme që institucioni ka miratuar. Evidenca nr 51. Praktika e ndjekur per auditim nga Njesia e Auditit te Brendshem; Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetore FSHMT;
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe	Departamenti mundëson raportin vjetor të analizës së veprimtarive akademike. Ky raport analizon gjendjen e programit duke iu përgjigjur disa prej problematikave që mund




cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	të jenë shfaqur dhe propozon ndryshimet e mundshme që mund të përmirësojnë situatën. Në përgjithësi, çdo vit akademik, studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim. Ky vlerësim bëhet elektronikisht, me një sërë pyetjesh mbi cilësinë e zhvillimit të mësimin nga pedagogu, apo cilësinë e literaturës ku bazohet lënda, gatishmërinë e pedagogut për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve të lëndës, apo për t'i sqaruar në lidhje me rezultatet e vlerësimit të përvetësimit të dijeve. Evidenca nr 97. Tabelat permbledhëse ASCAL; Evidenca nr 67. Shembull Pyetesor Vleresim i studenteve per lendet e programit te studimit formular; Evidenca nr 68. Shembull Pyetesor Vleresim i studenteve per UMT formular; Evidenca nr 27. Pyetesori i studenteve ne FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetesorit te studenteve 2023;			
Konkluzione	<i>Përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Karrierës, Fakulteti mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Sipas deklarimeve të institucionit, pavarësisht përpjekjeve, mungon ndërveprimi me studentët e diplomuar</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	UMT u ka dhënë hapësirën e duhur studentëve për të qenë pjesë integrale e institucionit. Në statut, rregullore dhe në çdo akt tjetër të institucionit, studentët janë pjesë e diskutimeve dhe



dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të vetë institucionit.	vendimmarrjes. Studentët janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë, përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillin e etikës, Komisionet e zgjedhjeve, njësinë e sigurimit të cilësisë etj. Evidenca nr 126. Rregullore e zgjedhjeve te Keshillit Studentor ne UMT; Evidenca nr 25. Perberja e Këshillit Studentor UMT; Evidenca nr 127. Statuti i Keshillit Studentor UMT,; Evidenca nr 124. Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT FSHMT; Takimi me studentë;
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli Studentor i është një organizëm i pavarur i studentëve i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMT, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. UMT inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre, parashikuar kjo shprehimisht në dispozitat e Statuti të institucionit. GVJ konstaton se FSHMT përdor sistemin e vlerësimit të performancës së stafit akademik, nëpërmjet pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik GVJ konsatoi se studentët janë pjesë e disa komisioneve në të cilën japin kontributin e tyre (Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, Grupit të RVB). Evidenca nr 126. Rregullore e zgjedhjeve te Keshillit Studentor ne UMT; Evidenca nr 25. Perberja e Këshillit Studentor UMT; Evidenca nr 127. Statuti i Keshillit Studentor UMT; Evidenca nr 100. Rregullore per Organizimin e Zgjedhjeve per Autoritetet, Organet Drejtuese, Komisionet; Takimi me studentët;
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	Studentët deklaruan se merret mendimi i tyre në përmirësimin e programit të studimit. Ata pyeten nga pedagogët për temat ose

studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	orët në dispozicion. Nga ana tjetër, Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive. Sipas statutit, përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohet me pjesëmarrjen e tyre në organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, GVB, RVB, Senat Akademik etj. Gjithashtu studentët plotëojnë dy pyetësorë në lidhje me vlerësimin e stafit akademik, njëri për lëndën dhe tjeri për institucionin. Kjo është një procedurë e unifikuar që UMT përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. Evidenca nr 25. Perberja e Këshillit Studentor UMT; Evidenca nr 124. Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT_FSHMT; Takimi me studentë; Evidenca nr 130. Politika dhe praktika per fitimin e bursave te studenteve dhe perjashtimi nga tarifa vjetore e studimit;			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në aktet rregullatore studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre. Sipas rregullores NJSBC, janë përcaktuar praktikat ku studentët mund të vlerësojnë kryerjen e procesit të vlerësimit apo mësimdhënies me anë të anketimeve anonime që kryejnë dy herë në vit. Sipas <i>nenit 46</i> të rregullores së FSHMT, parashikohet ankimimi, ku studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rrezultatit e marrë, nëpërmjet ankimimit zyrtar drejtuar komisionit brenda 24 orëve. Komisioni është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë. Evidenca nr 181.Rregullore e funksionimit NjsBC-UMT; Evidenca nr 5.Rregullore FSHMT;			
Konkluzione	<i>UMT përfshin dhe angazhon studentët në Senatin Akademik, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Një përfaqësues i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UMT ka strukturë të posaçme që siguron këshillimin e studentëve, orientimin e tyre si dhe komunikimin me personelin akademik. Zyra e shërbimit ndaj studentëve e cila siguron dhe mbështet orientimin dhe komunikimin e studentëve për programin e studimit dhe është përgjegjëse për ecurinë e tyre në institucion. Institucioni ofron lehtësira të komunikimit të brendshëm të personelit akademik dhe studentëve të tij. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në bazë të rregulloreve përkatëse dhe në përputhje me statutin dhe aktet rregullatore të institucionit. Evidenca nr 1 Statuti UMT; Evidenca nr 3. Organigrama; Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarise mesimore; Evidenca nr 180. Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT; Evidenca nr 107 Manuali i karrierës se studenteve FSHMT;
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Realizimi i tutoriatit kryhet në nivel njësie bazë dhe mundëson komunikimin e drejtpërdrejtë të studentit me pedagogët e tij. Departamenti kryen mbledhje të hapura me pedagogë e studentë për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Për sa i përket komunikimit të jashtëm, institucioni ofron mundësitë e komunikimit dhe ndërveprimit nëpërmjet sistemit të institucionit, rrjeteve sociale, adresat e-mailit, posterat e afishuara në këndet e informimit etj Evidenca nr 164. Rregullore e sekretarisë mësimore;

	Evidenca nr 180. Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT; Evidenca nr 107 Manuali i karrierës se studenteve FSHMT; Takimi me personelin administrativ;
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	FSHMT në bashkëpunim me Zyrën e karrierës organizon aktivitetet për njohjen e studentëve me institucionin, pedagogët, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit. Zyra e Karrierës ofron informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit. Nga ana tjetër, departmenti ka caktuar një pedagog në rolin e këshilluesit të karrierës. GVJ identifikoi si praktikë të mirë ndërveprimin e studentëve me departamentin, stafin dhe zyrat mbështetëse ndaj studentëve lidhur me informimin dhe dhënien e informacioneve për punësim. Rezultate do të shihen në punësimin e studentëve që do të diplomohen nëse ato kanë qenë ose jo rezultative. Bazuar në takimin me studentët rezulton se fakulteti ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në UMT, organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, mban kontakte dhe grumbullon informacione mbi punësimin e Alumnit, harton Guidën Studentore, Materialet udhëzuese për studentët, harton dhe raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve aktualë, studentëve të diplomuar etj. Evidenca nr 108. Aktivitete te zyres se karrieres FSHMT; Evidenca nr 97. Tabelat Permbledhese;
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve materiale edhe broshura informuese për t'i orientuar ata drejt tregut të punës dhe punësimit. Paralelisht asistohen për përgatitjen e rezumeve, formateve të CV-ve, letrave të shprehjes së interesit për punë, dhe aftësive të tyre për të fituar intervistat, në zbatimin e vendimeve që marrin dhe duke i mësuar se si të kryejnë një kërkim për punë apo të planifikojnë një kualifikim tjetër profesional. Në UMT dhe FSHMT funksionon prej vitesh Zyra e karrierës e cila përveç regjistrimit të studentëve të diplomuar do të ndjekë ata pas përfundimit të studimeve. Kjo zyrë përgatit raporte



	statistikore lidhur me përqindjen e studentëve të punësuar në çdo program studimi. Evidenca nr 108. Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT; Evidenca nr 97. Tabelat Permbledhese; Evidenca nr 80. Raporte vjetore;			
Konkluzione	<i>UMT ka struktura për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Ata kanë të drejtë të përfshihen dhe angazhohen në jetën akademike të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UMT ka të ngritur në nivel institucional Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e cila funksionon në bazë të statutit dhe rregullores. Institucioni ka miratuar me vendim të Senatit Akademik, Rregulloren e sigurimit të cilësisë ku përcaktohen mekanizmat e sigurimit të cilësisë. Prej pandemisë Covid 19, UMT dhe njësitë përbërëse përfshirë dhe FSHMT, kanë hartuar udhëzues përkatës për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UMT përdor metoda inovatore të mësimdhënies dhe të të nxëniet me në qendër studentin. Trajnimi i personelit akademik që jep mësim

	për herë të parë nga shefat e departamenteve, duke përcjellë praktikat më të mira dhe eksperiencat e tyre te akademikët e rinj. Evidenca nr 170. Plani satrategjik i zhvillimit te UMT;
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Strukturat përgjegjëse që monitorojnë cilësinë në UMT janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Departamentet përkatëse në secilin Fakultet. Bazuar në Rregulloren e sigurimit të cilësisë, komisioni është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme, për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm. Për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë të cilat kanë nevojë të konsolidohen dhe të standardizohen si procese permanente që kryhen në nivel institucional dhe në nivel programi, NJSBC ka rol kryesor. Njësia e Sigurimit të Cilësisë me monitorim të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë harton pyetësorë për studentët të cilët vlerësojnë instruktorin dhe lëndën të cilën po ndjekin. Evidenca nr 97. Tabelat permbledhëse ASCAL; Evidenca nr 67. Shembull Pyetesor Vleresim i studenteve per lendet e programit te studimit formular; Evidenca nr 68. Shembull Pyetesor Vleresim i studenteve per UMT formular; Evidenca nr 27. Pyetesori i studenteve ne FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetesorit te studenteve 2023;
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UMT nëpërmjet NJSBC garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përmes anketave dhe plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime. NJSBC përgatit raport vjetor duke analizuar informacion e mbledhur nga anketimi i studentëve. Edhe proceset që kryhen gjatë vitit akademik të parashikuara në planin vjetor të punës, më tepër janë aktivitete të institucionit se sa një politikë e qartë me mekanizma dhe aktivitete për sigurimin e cilësisë. NJSBCe fakultetit zhvillon pyetësorë në mënyrë të vazhdueshme me studentët ku vlerësohet cilësia në mësimdhënie. UMT ka zhvilluar online vitin e kaluar një pyetësor me studentët. Rezultatet e këtij pyetësori janë bërë publike Evidenca nr 68. Shembull Pyetesor Vleresim i studenteve per UMT formular;

	Evidenca nr 27. Pyetësi i studentëve në FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023; Evidenca nr 180. Rregullore e funksionimit NjsBC-UMT;
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përmes anketave dhe plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime. NJSBC përgatit raport vjetor duke analizuar informacione të mbledhur nga anketimi i studentëve dhe vlerësime të tjera tematike që kryhen gjatë vitit akademik. Proceset që kryhen gjatë vitit akademik të parashikuara në planin vjetor të punës, janë aktivitete të institucionit të ndërthurura me ato të njësive kryesore me fokus sigurimin e cilësisë. GVJ konstaton se UMT sapo ka përfunduar akreditimin institucional periodik dhe disponon informacione të plota që lidhen me procese të sigurimit të cilësisë në nivel institucional dhe të fakulteteve. Evidenca nr 84-85. Analize vjetore DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 155. Shembull i vlerësimit të performancës të stafit administrativ; Evidenca nr 153. Shembull raportim i aktivitetit shkencor personelin akademik; Evidenca nr 80-81-82. Raportimi vjetor FSHMT; Takimi me drejtuesit e fakultetit, Takimi me NJSBC;
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstaton se nga vlerësimet e kryera përmes anketimeve të studentëve, bëhet e mundur nxjerrja në pah praktikave të mira të përmendura nga studentët. Kjo motivon personelin akademik të përmirësojë metodat e mësimdhënies. Këto procese të realizohen duke përfshirë të gjithë kontribuesit e institucionit që të ndihmojnë në krijimin e kulturës së cilësisë në nivel institucional. Në pyetësorin e vitit të kaluar të paraqitur në dokumentacion, në një seksion të veçantë të tij, studentët kanë vlerësuar në mënyrë nominale pedagogëve tyre. Nga sa më sipër, rezultoni se UMT nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies evidente këto edhe në FSHMT. Evidenca nr 80-81-82. Raporte vjetor FSHMT;

	Evidenca nr 79. Raporti vjetor UMT; Evidenca nr 27. Pyetësori i studenteve ne FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetësorit te studenteve 2023; Evidenca nr 180. Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT; Takimi me NJSBC;			
Konkluzione	<i>UMT ka ngritur strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë që janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ndërkohë çdo strukturë tjetër përfshirë fakultetin dhe Departamentet përkatëse janë pjesë e këtij sistemi që garantojnë dhe promovojnë cilësinë e mësimdhënies. UMT ka rregullore, ka udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave për monitorimin e cilësisë. Këto mekanizma aplikohen në mënyrë periodike, zhvillohen më tej në kuadër të përmirësimit të tyre</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatorë institucionale.	Në zbatim të standardeve shtetërore të cilësisë UMT prej vitesh ka implementuar dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. Një rol të rëndësishëm në veprimtaritë e institucionit luajnë komisionet e ngritura në nivel institucional për qëllime të ndryshme sikundër janë: Komisioni i administrimit të zgjedhjeve në UMT, Komisioni i apelimit, Komisionet e përhershme, Asambleja e personelit akademik Evidenca nr 126. Rregullore e zgjedhjeve te Keshillit Studentor ne UMT; Evidenca nr 3. Organigrama UMT;

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Evidenca nr 1.Statuti UMT; NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore. Fakulteti ka njësinë e vet dhe ka përcaktuar një person përgjegjës i cili koordinon procesin e sigurimit të cilësisë në fakultet dhe bashkërendon punën me NJSBC në nivel institucional. Drejtoria e zhvillimit të kurrikulave, dekanatet e fakulteteve, sigurojnë qasje të reja në metodologjinë e mësimdhënies, përdorimit të teknologjisë dhe inovacionit si dhe promovojnë praktikën e mira të mësimdhënies me metoda bashkëkohore. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm, si urdhërat, partnerët shëndetësorë etj. Evidenca nr 1.Statuti UMT; Evidenca nr 180.Rregullorja NJSBC; Evidenca nr 69. Perberja e Njsbc-VSA nr.103, dt.20.10.2020; Evidenca nr 170.Plani strategjik; Evidenca nr 79. Raporte vjetore UMT, Takimi me NJSBC;
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	NJSBC përdor instrumente sasiore dhe cilësore për përmirësimin e cilësisë, ku përfshijnë anketimin e studentëve, pyetësorët për pedagogët, formularin e vlerësimit të pedagogëve, dhe tryezat e hapura, rishikimin e literaturës për lëndën. Janë angazhuar përmes NJSBC edhe ekspertë të jashtëm të cilët sjellin mendimin e tregut ose partnerëve në universitet. Në nivel fakulteti, kryet vlerësimi i performancës të personelit akademik në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti paraprak i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit etj. Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm institucional i UMT, ka në përmirësimin e cilësisë dhe mekanizmave të sigurimit të saj brenda UMT. Evidenca nr 80-81-82. Raporte FSHMT; Evidenca nr 27. Pyetësori i studenteve në FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetësorit të studenteve 2023; Takimi me NJSBC;
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin	Universiteti përdor tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e arritjeve. Këto tregues janë nxjerrë nga aktet e institucionit p.sh Udhëzimi 29 i MAS. Ka një hierarki funksionimi dhe mbikqyrje që mban nën kontroll të

gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatorë institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	vazhdueshëm zbatimin me rigorozitet të rregulloreve. Dekani, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i programit, përfaqësuesi i NJSBC në Fakultet koordinojnë dhe mbikqyrin vazhdimisht zbatimin e programit mësimor. Institucioni organizon audite të brendëshme të drejtuar nga NJSBC për dokumentacionin e çdo programi dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Evidenca nr 80-81-82. Raport vjeotr FSHMT; Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ;			
Konkluzione	<i>UMT ka hartuar dhe zbaton rregulloren përkatëse dhe procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në përgjithësi, dhe të MSc. në Teknik Imazherie në veçanti, ku ka ngritur NJSBC si strukturë e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NJSBC është përgjegjëse për zbatimin e gjithë instrumenteve për matjen sasiore dhe cilësore të cilësisë në mësimdhënie, dhe rekomandimeve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin	UMT përdor mekanizma e procese të sigurimit të cilësisë të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit MSc. Teknikë Imazherie. Në këto procese realizohet evidentimi i arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. P.sh sikundër është theksuar në takime, një nga propozimet e kryera në kuadër të përmirësimit të programit, ka qenë përfshirja e orëve të praktikës në çdo lëndë për të rritur raportin midis teorisë dhe praktikës. Raportimet periodike, diskutimet në departamente dhe dekanat, janë pjesë po

e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	ashtu e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit. Përveç kësaj, periodikisht kryhen monitorime të procesit mësimor nga përgjegjësit e departamenteve dhe më pas analizohen gjetjet dhe konstatimet. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ku ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre. Evidenca nr 80-81-82. Raportet vjetore FSHMT; Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 11. Praktikë për miratimin e planeve mësimore; Takim me drejtuesit; Takim me personelin administrativ;
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në takimin me Njësinë e sigurimit të cilësisë dhe përfaqësues të Drejtorisë së kurrikulave, GVJ u informua se në funksion të sigurimit të cilësisë UMT ka në zbatim kodin e cilësisë i cili garanton cilësinë edhe promovimin e saj në universitet. Vetë NJSBC përgatit raportet e vlerësimit dhe planin e punës për aktivitetet e saj, me detyra konkrete, ku përshkruhet: emërtimi, përshkrimi detyrës, periudha e kryerjes, rezultati i pritshëm. Përmes planit të punës, NJSBC adreson problematikat dhe mangësitë e vërejtura, si dhe motivon personelin akademik për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC. Evidenca nr 80-81-82. Raportet vjetore FSHMT; Evidenca nr 84-85. Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ; Evidenca nr 11. Praktikë për miratimin e planeve mësimore, Takim me NJSBC;
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i	Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe në takimin me anëtarët e NJSBC, u deklarua se NJSBC merr informacion të përvitshëm për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste të standardizuara nëpërmjet Clean

cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Score, rezultatet nga pranimet në vitet e para, provimi i shtetit i zhvilluar nga QSHA etj. Universiteti përdor dhe mekanizma të tjerë në kuadër të monitorimit dhe përmirësimit të niveleve të cilësisë p.sh procesi i vlerësimit të studentëve sa është adekuat, niveli i zhvillimit të praktikave profesionale në mjediset spitalore mendimi i partnerëve për studentët e programit etj. Në takimin me personelin u deklarua se vetë stafi që është angazhuar në mjediset spitalore, sjell dhe mendimin dhe vlerësimin e profesionistit shëndetësor duke qenë se ata janë kontakti i parë me studentin në mjediset spitalore. Evidenca nr 1.Statuti UMT; Evidenca nr 180.Rregullorja NJSBC; Evidenca nr 69. Perberja e Njsbc-VSA nr.103, dt.20.10.2020; Evidenca nr 170.Plani strategjik; Evidenca nr 79. Raporte vjetore UMT; Evidenca nr 80.Raport vjetor FSHMT; Takimi me NJSBC;
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e	GVJ konstaton se Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e Universitetit nëpërmjet projektit GRADUA. Marrja e mendimit të studentëve të diplomuar të programit të studimit shërben si metod e tërthortë vlerësimi. Sikundër kemi theksuar, NJSBC e fakultetit ka shpërndarë pyetësorë të studentëve, të atyre të diplomuar që janë aktualisht në master dhe ka hartuar një raport vlerësimi të përgjigjeve të dhëna. Rezultatet e dala nga përpunimi i informacioneve të grumbulluara, si nga studentët apo dhe nga analiza të tjera të kryera mbahen në konsideratë nga organet drejtuese të UMT, me qëllim përmirësimi në të ardhmen të programit të studimit. Evidenca nr 169. RVB institucionale UMT Maj 2022; Evidenca nr 80-81-82. Raporte FSHMT; Evidenca nr 27. Pyetësori i studenteve ne FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetësorit te studenteve 2023;

kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	UMT dhe FSHMT përmes strukturës së NJSBC, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit MSc në Teknikë Imazherie përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të cilësisë së mësimdhënies, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, dhe rezultateve të synuara të të nxënëit. Janë shpërndarë pyetësorë të studentëve, të atyre të diplomuar që janë aktualisht në master dhe ka hartuar një raport vlerësimi të përgjigjeve të dhëna. Rezultatet e dala nga përpunimi i informacioneve të grumbulluara, si nga studentët apo dhe nga analiza të tjera të kryera mbahen në konsideratë nga organet drejtuese të UMT, me qëllim përmirësimi në të ardhmen të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka eksperiencë në disa procese akreditimi institucional dhe të programeve të studimit gjatë këtyre viteve të funksionimit të tij. Nëpërmjet këtyre proceseve është arritur standardizimi i politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të cilat garantojnë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në statut, rregullore janë reflektuar modalitetet që garantojnë përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Përbërja e strukturës së NJSBC siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

	Ndërsa ekspertët e jashtëm janë përfshirë në studimin e tregun të punës e vlerësuar kjo pozitivisht nga ana e GVJ. GVJ konstaton se e drejta për tu bërë pjesë në këto procese është e garantuar dhe kjo e drejtë ushtrohet nga stafi, studentët dhe partnerët jashtë institucionit. Evidenca nr 2. Rregullore UMT; Evidenca nr 5. Rregullore FSHMT;
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e UMT. Njësia bazë ka marrë rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit. Nuk u evidentuan raste të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Në FSHMT përcaktohen detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Evidenca nr 80-81-82. Raporte FSHMT; Evidenca nr 27. Pyetësi i studenteve në FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetësorit të studenteve 2023;
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Universiteti ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve të mjekësisë si pjesë e personelit akademik që punojnë në qendrat spitalore universitare. GVJ konstaton se kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit. Përveç stafit mjekësor të spitaleve universitare që janë pjesë e universitetit sipas VKM, ka angazhime edhe të personelit nga institucione shëndetësore private që kanë kualifikim në drejtime specifike. Nga takimet me personelin akademik e administrativ, GVJ konstatoi se ekziston një frymë bashkëpunimi ndërmjet aktorëve brenda institucionit përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe partnerëve apo stafit të jashtëm. Evidenca nr 80- 81- 82. Raportet vjetore FSHMT;
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit me strukturat e institucionit në mënyrë që

brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	veprimtaritë e sigurimit të cilësisë mos shihen si detyrë vetëm e NJSBC por si proces në të cilin integrohen dhe përfshihen të gjithë aktorët e institucionit, vlerësohet pozitiv. Duke pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm mes KPSSC dhe NJSBC si dhe përfshirjen dhe komunikimin e vazhdueshëm me stafin administrativ dhe studentët gjë e cila shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Evidenca nr 116. Projekti i Qendres se Biosimulimit klinik dhe Edukimit ne vazhdim UMT; Evidenca nr 146. Sherbimet e Telemjekesise; Evidenca nr 180.Rregullorja NJSBC; Evidenca nr 69. Perberja e NJSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020; Evidenca nr 172.Kodi i etikes, Statuti;			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sikundër kemi përmendur, GVJ identifikon shembuj pozitivë të angazhimit të aktorëve të jashtëm të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë apo si pjesë e ofrimit të kontributit në praktikën profesionale dhe edukimin në vazhdim. <i>GVJ do të sugjeronte që institucioni të marrë parasysh, komentet nga partnerët e jashtëm, urdhrat, komunitetet profesionale, studentët që punojnë jashtë vendit, si përvojë e vlefshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</i> Si rezultat i përdorimit të sistemit të menaxhimit ky proces është lehtësisht i realizueshëm duke bërë të mundur raportimin në kohë reale për veprimtaritë që kryhen nga njësite respektive. Evidenca nr 97. Tabelat përmbledhëse; Evidenca nr 108. Statistika zyra e karrierës; Evidenca nr 107. Manuali i karrierës se studenteve FSHMT;			
sKonkluzione	GVJ konstaton se institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë janë konsoliduar duke mundësuar dhënien e kontributeve nga njësitë bazë, njësitë kryesore, personelin akademik dhe studentët, partnerët dhe palët e interesuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UMT si institucion publik, ka detyrimin ligjor për të qenë transparent lidhur me politikat e informimit. GVJ konstaton se UMT ka publikuar në mënyrë transparente dhe publike politikat, strategjinë dhe veprimtarinë e NJSBC. Gjithashtu, UMT ka të publikuara në faqen e tij www.umed.edu.al edhe raportet vjetore. Një seksion i veçantë është kushtuar programit të transparencës në përputhje me Ligjin për të drejtën e informimit. Dokumentet janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit. . www.umed.edu.al - Rregullore e drejtorisë së informimit; Evidenca nr 181. Rregullore e funksionimit të NJSBC – UMT;
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në faqen e internetit të institucionit ka informacion në lidhje me veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë për institucionin në tërësi dhe për programet e studimit në veçanti. Në UMT dhe FSHMT respektohet liria dhe etika akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Institucioni ka “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale”. Vetë fakulteti ka faqen zyrtare të internetit në të cilën publikohen raportet dhe informacione mbi veprimtaritë akademike. www.umed.edu.al, www.fshmt.edu.al
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni i shoqëron rezultatet e vlerësimit me plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Plani i masave përgatitet për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit”. (P.sh plani i masave për plotësimin e një rekomandimi nga akreditimi i mëparshëm institucional). Një pjesë e informacioneve që lidhen me sigurimin e cilësisë janë kryesisht informuese ndërsa sikundër është deklaruar në takime,

	institucioni është i hapur për këdo për të dhënë informacione të detajuara në institucion në versionin e printuar apo elektronik. GVJ konstaton se pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat repsektive, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna. Evidenca nr 80-81-82. Raportet vjetore FSHMT; Takimi me drejtuesit;			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UMT monitoron zbatimin e masave në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit, duke raportuar në mënyrë të vazhdueshme në Rektorat dhe Senatin akademik. GVJ konstaton se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Evidenca nr 27. Pyetësi i studenteve në FSHMT 23; Evidenca nr 28. Rezultatet e pyetësorit të studenteve 2023; Takimi me studentë;			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Monitorimi i ecursë, kontrolli, auditimi dhe raportimi është i vazhdueshëm në UMT. GVJ identifikon shembuj pozitivë të angazhimit të aktorëve të jashtëm të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë apo si pjesë e ofrimit të kontributit në praktikën profesionale dhe edukimin në vazhdim. Organizimi i veprimtarive periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, është konsideruar pozitive nga ana jonë. www.umed.edu.al www.fshmt.edu.al			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Proceset, veprimtaritë dhe rezultatet e tyre për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike në faqen e institucionit dhe të aksesueshme nga publiku : www.umed.edu.al .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: "Teknikë Imazherie"

a. Pikat e forta:

1. Fakulteti ka mundësi të shumta për shkak të përkatësisë së qendrave spitalore si pjesë UMT duke u ofruar studentëve mundësi të shumta për zhvillimin e praktikave;
2. Program i konsoliduar dhe i përshtatur me nevojat që ka shërbimi diagnostik në vend duke reflektuar zhvillimet e reja në fushën e imazherisë;
3. Përmbajtja e programit përputhet me programe të njohura në nivel ndërkombëtar;
4. Përfshirja e teknikë imazherie si mbikëqyrës të praktikave profesionale që aktualisht janë staf i QSUT ose në qendra të tjera diagnostike;
5. Pjesë e personelit akademik janë stafet mjekësore të QSUT cka ndihmon shumë në sjelljen e eksperincës klinike dhe transmetimin e saj tek studentët;
6. Infrastruktura laboratorike me laborator të imazherisë digjitale, laborator i anatomisë radiologjike;
7. Libraritë online, "E-Research", "Training4ALL", "Virtual university", "U-Library;


b. Pikat e dobëta:

1. Literatura bazë dhe e rekomanduar në disa nga programet e lëndëve nuk i përkasin botimeve të viteve të fundit; (*Standarti II.3, kriteri 4; Standarti IV.3, kriteri 2*)
2. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi edhe të stafit akademik me Msc, jo sipas parashikimit të nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015, ku përcaktohet niveli i duhur i kualifikimit akademik; (*Standarti IV.1, kriteri 1*)

3. Mosmbulimi i lëndëve apo moduleve të programit të studimit, që lidhen me imazherinë dhe profesionin, nga titullarë të së njëjtës fushë; (*Standarti IV.1, kriteri 4*)
4. Mungesa e komenteve nga partnerët e jashtëm, urdhrat, komunitetet profesionale, studentët që punojnë jashtë vendit, si përvojë e vlefshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies; (*Standarti VI.4, kriteri 5*)

Rekomandime:

1. Përditësimi i programeve të lëndëve në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore, duke i dhënë peshën e duhur literaturës kryesisht të 5 viteve të fundit;
2. Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;
3. Institucioni të përfshijë në programin e studimit staf akademik qoftë nga partnerët a bashkëpunorët apo edhe të ftuar, dhe të gjejë rrugë dhe mekanizma alternativë në mënyrë që lëndët apo modulet e programit që lidhen me imazherinë dhe profesionin të mbulohen nga titullarë të së njëjtës fushë;
4. Departamenti të mbështesë personelin të hartojë dhe botojë tekste të viteve të fundit për imazherinë që sikundër janë botuar edhe tekste për programet e tjera;
5. Institucioni të marrë parasysh, komentet nga partnerët e jashtëm, urdhrat, komunitetet profesionale, studentët që punojnë jashtë vendit, si përvojë e vlefshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies;
6. Institucioni të hedh në sistem Rregulloren e programit Msc Teknik imazherie;




Evaluation's conclusions for the second level of study Master fo Science in "Imaging technician"

a. Strengths and affirmations:

1. Faculty has potential to provide students plenty of possibilities for professional practicing, by being part of University Hospital centre;
2. It is consolidated program and tailored according to imaging service in our country, by reflecting last development of the area;
3. Content of the subjects and modules are similar with well-known programs at international area;
4. Engagement of imaging technicians as practice supervisors that are employee of University Hospital Centre or in other diagnostic centres;
5. Full time professors are members of University Hospital Centre, which brings know how and experience, in order to transmit it to the students;
6. Laboratory infrastructure is well equipped with: digital imaging laboratory, laboratory of radiology's anatomy;
7. On line libraries: "E-Research", "Training4ALL", "Virtual university", "U-Library;


b. Weaknesses:

1. Basic and recommended literture for some of subject's syllabus does not belong to last years published books (*Standard II.3, criteria 4; Standard IV.3, criteria 2*);
2. Engagement in teaching process of this program even academic staff with Msc grade, which is not in accordance with Article 59/6 of the Law no. 80/2015, whcih defines proper level of academic qualification (*Standard IV.1, criteria 1*);
3. There are some subjects or modules, related to imaging and profession, that are not covered from professors of the same area (*Standard IV.1, criteria 4*);
4. Lack of comments from outsider partners, as: professional orders, professional communities, alumni employed abroad, as helpful experience in order to improve quality of the teaching (*Standard VI.4, criteria 5*)



Recommendation:

1. Updating subject's syllabus in accordance with legal framework requirements, by using literature of the last 5 years;
2. Institution should engage in teaching process only academic staff with PHD grade, in accordance with requirements of the legal framework for proper academic qualification;
3. Institution should engage in teaching process academic staff from partner institutions or invited professors, and find proper alternatives in order to cover subjects and modules related to profession, with professors of the same area;
4. Department should support professors to update, prepare and publish teaching books for imaging;
5. Institution should take in consideration comments from the outsider partners, as: professional orders, professional communities, alumni employed abroad, as helpful experience in order to improve quality of the teaching;
6. The institution puts into the system the Regulation of the master of Science Imaging Technician program;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

